



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.18**

**14 mars**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 12/2012 datë 16.2.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Sllovenisë për shlyerjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Republikës së Sllovenisë.....	735
Ligj nr. 13/2012 datë 16.2.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe e Organizatës për Ndalimin e Armëve Kimike, për të drejtat dhe imunitetet e ONAK-ut .....	738
Ligj nr. 14/2012 datë 16.2.2012	Për një ndryshim dhe shtesa në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar.....	746
Ligj nr. 15/2012 datë 16.2.2012	Për një ndryshim dhe shtesa në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar.....	747
Ligj nr. 16/2012 datë 16.2.2012	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar.....	748
Ligj nr. 17/2012 datë 16.2.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	749
Ligj nr. 18/2012 datë 23.2.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për ndryshimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve.....	751
Ligj nr. 19/2012 datë 23.2.2012	Për ratifikimin e ndryshimit të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve.....	753

Vendim i Kuvendit nr. 12/2012 datë 23.2.2012	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar.....	754
Vendim i GJK nr. 7, datë 27.2.2012	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji.....	755
Vendim i GJK nr. 8, datë 28.2.2012	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën, të vendimeve nr. 153, datë 15.4.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr. 445, datë 18.12.2008 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 130 datë 12.2.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	763
Vendim i GJK nr. 9, datë 29.2.2012	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 626, datë 10.10.2007 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.....	768

**LIGJ**  
**Nr. 12/2012**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË PËR  
SHLYERJEN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NDAJ REPUBLIKËS SË  
SLLOVENISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Sllovenisë për shlyerjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Republikës së Sllovenisë.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.2.2012

**Shpallur me dekretin nr.7303, datë 6.3.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË MBI SHLYERJEN E BORXHIT TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NDAJ REPUBLIKËS SË SLLOVENISË**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Sllovenisë, më poshtë të quajtura “palët”,

me qëllim që:

- të zhvillojnë bashkëpunim afatgjatë dhe të qëndrueshëm ekonomik dhe financiar, bazuar në parimet e përfitimeve të përbashkëta;

- të finalizojnë shlyerjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Republikës së Sllovenisë; dhe

- në pajtim me memorandumun ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Qeverisë së Republikës së Serbisë, Qeverisë së Republikës së Sllovenisë, Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Qeverisë së Malit të Zi mbi shlyerjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë në lidhje me shlyerjen e shumave në llogaritë sipas shkëmbimit të mallrave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, të nënshkruar më 14 dhjetor 2010 në Tiranë, Shqipëri,

kanë rënë dakord si më poshtë:



## Neni 1

Palët konfirmojnë që:

1. Gjendja përfundimtare për shlyerje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Sllovenisë, duke përfshirë interesin e rregullt të llogaritur për periudhën nga 31 mars 2006 deri më 30 shtator 2009, arrin në 3,815,421.48 dollarë kleringu (me fjalë: tre milionë e tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e njëzet e një e 48/100 dollarë kleringu).

2. Shuma e parashikuar në pikën 1 të këtij neni përbën borxhin e Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës së Sllovenisë në dollarë kleringu të datës 30 shtator 2009.

## Neni 2

Palët bien dakord që borxhi i llogaritur në USD, sipas parashikimit të nenit 1.2, konvertohet në borxhin e llogaritur në dollarë amerikanë (USD), duke zbatuar kursin e këmbimit prej një dollar kleringu = 1 dollar amerikan.

## Neni 3

Palët bien dakord që:

1. Pas konvertimit të përmendur në nenin 2, borxhi i Republikës së Shqipërisë ndaj Republikës së Sllovenisë, në datën 30 shtator 2009, bëhet 3,815,421.48 USD (me fjalë: tre milionë e tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e njëzet e një dhe 48/100 USD).

2. Borxhi i Republikës së Shqipërisë ndaj Republikës së Sllovenisë rritet me shumën e interesit të shtuar për periudhën nga 30 shtator 2009 deri në datën e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje. Norma e interesit të zbatueshëm është norma 6-mujore libor USD më 31 mars dhe 30 shtator të çdo viti dhe interesi kapitalizohet. Nëse 31 marsi ose 30 shtatori bie në një ditë pushimi në secilin prej vendeve, norma libor USD e zbatueshme është ajo e ditës pararendëse të punës. Nëse data e kësaj marrëveshjeje është e ndryshme nga 30 shtatori dhe 31 marsi, shuma e interesit të rregullt llogaritet në bazë të ditëve të mbetura dhe normës 6-mujore libor USD në ditët e marrëveshjes.

## Neni 4

Palët bien dakord për kushtet e mëposhtme për shlyerjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Republikës së Sllovenisë.

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave e Shqipërisë, në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, do të paguajë në llogarinë e specifikuar më parë nga Ministria e Financave të Republikës së Sllovenisë, shumën totale të borxhit në mënyrën e mëposhtme:

a) katër këste gjysmëvjetore të shumës principale me interesin e shtuar më 31 mars dhe 30 shtator të çdo viti, që këtu përcaktohen si data pagese;

b) data e parë e pagesës së shumës principale dhe interesit është në datën që vjen menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Ministria e Financave e Shqipërisë, në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, i paguan Ministrisë së Financave të Republikës së Sllovenisë interesin e rregullt duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

a) Interesi llogaritet bazuar në numrin faktik të ditëve që kanë kaluar dhe një vit me 360 ditë.

b) Norma e zbatueshme e interesit është 6 muaj libor USD më 31 mars dhe 30 shtator të çdo viti. Nëse data 31 mars ose 30 shtator bie ditë pushimi në secilin prej vendeve, norma e zbatueshme libor USD është ajo e ditës pararendëse të punës.

3. Interesi i zbatuar për pagesat e vonuara të shumës principale dhe interesit (kamatëvonesat) llogaritet me normën 6 muaj libor USD plus 4% në vit.

#### Neni 5

Palët bien dakord të zgjidhin me pajtim çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga kjo marrëveshje.

Nëse mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet miqësisht, palët bien dakord që mosmarrëveshja të zgjidhet përfundimisht në përputhje me rregullat e arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris, nga tre arbitra. Secila palë cakton një arbitër dhe këta dy anëtarë caktojnë një arbitër të tretë - Kryetarin e Gjykatës së Arbitrazhit.

Nëse palët nuk arrijnë të caktojnë një anëtar të tretë - Kryetarin e Gjykatës së Arbitrazhit, arbitri i tretë caktohet në pajtim me rregullat e arbitrazhit të përmendura më lart.

Vendimi i arbitrazhit është përfundimtar, detyrues për të dyja palët dhe i zbatueshëm brenda afatit të specifikuar në vendim.

Palët bien dakord që arbitrazhi të zhvillohet në pajtim me procedurën e përcaktuar nga rregullat e arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris. Ligji i zbatueshëm është ligji lëndor francez.

Arbitrazhi do të zhvillohet në Paris ose diku tjetër, nëse palët bien dakord që është e përshtatshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Gjuha e arbitrazhit është gjuha angleze.

#### Neni 6

Kjo marrëveshje ndryshohet vetëm me pëlqimin me shkrim të të dyja palëve.

#### Neni 7

Njoftimet e bëra në pajtim me këtë marrëveshje drejtohen si më poshtë:

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:  
Ministria e Financave  
Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit të Borxhit Publik  
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 1, Tiranë, Shqipëri  
Tel.: + 35542228405  
Faks: +35542228494

Për Qeverinë e Republikës së Sllovenisë:  
Ministria e Financave  
Zupanciceva 3  
SI - 1000  
Tel.: + 386 1 369 6670



## Neni 8

Marrëveshja miratohet sipas ligjeve të secilës palë. Ajo hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit diplomatik që konfirmon se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore për hyrjen e saj në fuqi.

Marrëveshja mbetet e vlefshme deri sa të përmbushen të gjitha detyrimet e të dyja palëve që rrjedhin nga kjo marrëveshje.

Bërë më .....2011, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

## LIGJ Nr. 13/2012

### **PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ORGANIZATËS PËR NDALIMIN E ARMËVE KIMIKE, PËR TË DREJTAT DHE IMUNITETET E ONAK-UT**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

## KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

### VENDOSI:

#### Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Ndalimin e Armëve Kimike, për të drejtat dhe imunitetet e ONAK-ut.

#### Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratur në datën 16.2.2012

**Shpallur me dekretin nr.7304, datë 6.3.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

## MARRËVESHJE

### NDËRMJET ORGANIZATËS PËR NDALIMIN E ARMËVE KIMIKE DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E ONAK (ORGANIZATA PËR NDALIMIN E ARMËVE KIMIKE)

*Duke pasur parasysh* që neni VIII paragrafi 48 i konventës “Mbi ndalimin e zhvillimit, prodhimit, depozitimit dhe përdorimin e armëve kimike dhe mbi shkatërrimin e tyre”, parashikon që ONAK të gëzojë në territorin dhe në çdo vend tjetër nën juridiksionin apo kontrollin e shtetit palë kompetenca të tilla ligjore, të drejta dhe imunitete të tilla ligjore sipas nevojës për ushtrimin e funksioneve të saj;

*duke pasur parasysh* që neni VIII paragrafi 49 i konventës “Mbi ndalimin e zhvillimit, prodhimit, depozitimit dhe përdorimin e armëve kimike dhe mbi shkatërrimin e tyre”, parashikon që të dërguarit/delegatët e shteteve palë, së bashku me alternuesit dhe këshilltarët e tyre, përfaqësuesit e emëruar pranë Këshillit Ekzekutiv, së bashku me alternuesit dhe këshilltarët e tyre, Drejtori i Përgjithshëm dhe stafi i Organizatës, të gëzojnë të drejta dhe imunitete të tilla sipas nevojës për ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre që lidhen me ONAK;

*pavarësisht* nga neni VIII, paragrafët 48 dhe 49 të konventës “Mbi ndalimin e zhvillimit, prodhimit, depozitimit dhe përdorimin e armëve kimike dhe mbi shkatërrimin e tyre”, privilegjet dhe imunitetet që gëzohen nga Drejtori i Përgjithshëm dhe stafi i Sekretariatit gjatë kryerjes së aktiviteteve verifikuese mbeten ato të përcaktuara në pjesën II, seksioni B, të shtojcës së verifikimit;

*duke pasur parasysh* që neni VIII paragrafi 50 i konventës “Mbi ndalimin e zhvillimit, prodhimit, depozitimit dhe përdorimin e armëve kimike dhe mbi shkatërrimin e tyre” specifikon që kompetenca, të drejta dhe imunitete të tilla ligjore do të përcaktohen në marrëveshje me Organizatën dhe shtetet palë,

tani, për pasojë, Organizata për Ndalimin e Armëve Kimike dhe Republika e Shqipërisë kanë rënë dakord si më poshtë.

#### Neni 1

#### Përcaktime

Në këtë marrëveshje:

a) “Konventë” nënkupton konventën “Mbi ndalimin e zhvillimit, prodhimit, depozitimit dhe përdorimin e armëve kimike dhe mbi shkatërrimin e tyre” të 13 janarit 1993.

b) “ONAK” nënkupton Organizatën për Ndalimin e Armëve Kimike të themeluar sipas nenit VIII, paragrafi 1 i Konventës.

c) “Drejtor i Përgjithshëm” nënkupton Drejtorin e Përgjithshëm të referuar në nenin VIII paragrafi 41 i konventës ose në mungesë të tij, Drejtorin e Përgjithshëm që e zëvendëson.

d) “Zyrtarë të ONAK” nënkupton Drejtorin e Përgjithshëm dhe të gjithë anëtarët e stafit të Sekretariatit të ONAK.

e) “Shtet palë” nënkupton shtetin palë të marrëveshjes aktuale.

f) “Shtete palë” nënkupton shtetet palë të konventës.

g) “Përfaqësues të shteteve palë” nënkupton kryetarët e akredituar të delegacioneve të shteteve palë në konferencën e shteteve palë dhe/ose pranë Këshillit Ekzekutiv ose delegatët në takime të tjera të ONAK.

h) “Ekspertë” nënkupton persona të cilët në kapacitetin individual të tyre, realizojnë detyra të autorizuara nga ana e ONAK, shërbejnë në organet e saj/ONAK, apo persona të cilët, në një mënyrë, me kërkesë të saj, konsultojnë ONAK;

i) “Takimet e thirrura nga ONAK” nënkupton çdo takim të secilit prej organeve apo organeve të varura nga ONAK ose çdo konferencë ndërkombëtare apo takime të tjera të thirrura prej saj/ONAK.



j) “Pasuria” nënkupton të gjitha pasuritë, asetet, fondet që i përkasin ONAK ose që mbahen apo administrohen prej saj në ndjekjen e mëtejshme të funksioneve të saj sipas konventës dhe të gjitha të ardhurat e ONAK.

k) “Arkivat e ONAK” nënkupton të gjitha të dhënat, korrespondencën, dokumentacionin, dorëshkrimet, të dhënat kompjuterike dhe mediatike, fotografitë, videot dhe regjistrimet me zë, të cilat i përkasin ose ruhen nga ONAK apo çdo nëpunës i saj/ONAK-ut me funksion zyrtar dhe çdo material tjetër i cili, sipas gjykimit të Drejtorit të Përgjithshëm dhe shtetit palë, konsiderohet pjesë e arkivave të ONAK.

l) “Ambientet e ONAK” përbëhen nga godinat ose pjesë të godinave dhe territori ndihmës, nëse ekziston, të cilat përdoren për qëllime të ONAK-ut, përfshirë funksionet e referuara në kapitullin II nënparagrafi 11 (b) të shtojcës verifikuese të konventës.

## Neni 2 Autoriteti ligjor

ONAK zotëron autoritet të plotë ligjor. Në veçanti, ONAK ka autoritet:

- a) të kontraktojë;
- b) të zotërojë dhe të shesë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme;
- c) të iniciojë dhe të përfaqësojë në seanca ligjore.

## Neni 3 Të drejtat dhe imunitetet e ONAK-ut

1. ONAK dhe pasuria e saj, kudoqoftë e lokalizuar dhe prej kujtdoqoftë e zotëruar, gëzon imunitet nga çdo formë e procesit ligjor, përveçse në ndonjë rast të veçantë kur ONAK ka hequr dorë në mënyrë të qartë nga imuniteti i saj. Kuptohet, gjithashtu, se asnjë heqje dorë nga imuniteti nuk çon në marrjen e ndonjë mase ekzekutuese.

2. Ambientet e ONAK-ut janë të paprekshme. Pasuria e ONAK, kudoqoftë e lokalizuar dhe prej kujtdoqoftë e zotëruar, gëzon imunitet ndaj kontrollit, rekuizimit, konfiskimit, shpronësimit dhe çdo mënyrë tjetër ndërhyrjeje, qoftë ky veprim ekzekutiv, administrativ, gjyqësor apo legjislativ.

3. Arkivat e ONAK-ut janë të paprekshme, kudo që të jenë të lokalizuara.

4. Pa u kufizuar nga kontrollet, rregulloret apo moratoriumet financiare të çdo lloji:

a) ONAK mund të zotërojë fonde në ar dhe monedha të çfarëdolloji dhe të kryejë veprime financiare në çdo monedhë;

b) ONAK mund të transferojë në mënyrë të lirë fondet, letrat me vlerë, arin dhe monedhat e tij në drejtim të shtetit palë dhe anasjelltas, në drejtim të çdo vendi tjetër dhe anasjelltas apo brenda shtetit palë dhe mund të konvertojë çdo monedhë të zotëruar në çdo monedhë tjetër.

5. ONAK, në ushtrimin e të drejtave sipas paragrafit 4 të këtij neni, i kushton vëmendjen e duhur çdo përfaqësimi të Qeverisë së Shtetit Palë për sa kohë që gjykohet se një gjë e tillë nuk pengon interesat e ONAK.

6. ONAK dhe pasuria e tij:

a) përjashtohet nga të gjitha taksat; kuptohet, gjithashtu, se ONAK-u nuk pretendon të përjashtohet nga taksat të cilat nuk kanë vlerë, në fakt, më të madhe se detyrimet për shërbimet komunale publike.

b) përjashtohet nga detyrimet doganore, kufizimet dhe ndalimet mbi importet dhe eksportet për sa u përket artikujve të importuar apo eksportuar nga ana e ONAK-ut për përdorim zyrtar; kuptohet, gjithashtu, se artikujt e importuar sipas përjashtimeve të tilla nuk nxirren në shitje në shtetin palë, përveçse në përputhje me kushtet e rëna dakord me të.



c) përjashtohen nga detyrimet, kufizimet dhe ndalimet mbi importet dhe eksportet për sa u përket publikimeve të tij.

7. Ndërkohë që ONAK, si rregull i përgjithshëm, nuk pretendon përjashtime nga detyrimet e taksave indirekte dhe taksat mbi shitjen e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, të cilat janë pjesë përbërëse të çmimit për t'u paguar, megjithatë, kur ONAK-ut kryen blerje të rëndësishme për përdorim zyrtar të pasurisë, mbi të cilat janë vendosur detyrime dhe taksa të tilla ose kur ato janë të taksueshme, shteti palë, kur është e mundur, ndërmerr masat e duhura administrative për shlyerjen apo kthimin e shumës së detyrimit apo taksës.

#### Neni 4

##### **Lehtësirat dhe imunitetet për sa u përket komunikimeve dhe publikimeve**

1. Për komunikime zyrtare të tij, ONAK, në territorin e shtetit palë dhe aq sa mund të jetë e pajtueshme sipas çdo konvente, rregulloreje apo marrëveshjeje ndërkombëtare në të cilat aderon shteti palë, gëzon një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që i atribuohet nga ana e qeverisë së shtetit palë çdo qeverie tjetër, përfshirë misionin diplomatik të kësaj të fundit, për sa u përket prioriteteve, tarifave dhe taksave për postën dhe telekomunikacionin dhe tarifatat e shtypit për informimin mediatic.

2. Asnjë censurë nuk aplikohet kundrejt korrespondencës zyrtare dhe komunikimeve të tjera zyrtare të ONAK-ut. ONAK gëzon të drejtën të përdorë kode dhe të shpërndajë dhe të mbajë korrespondencë dhe komunikime të tjera zyrtare me postë ose në zarfe të vulosura, të cilat mbartin të njëjtat të drejta dhe imunitete si posta dhe pakot diplomatike. Asgjë në këtë paragraf nuk përjashton marrjen e masave të duhura paraprake të përcaktuara me marrëveshje ndërmjet Shtetit Palë dhe ONAK.

3. Shteti palë njeh të drejtën e ONAK për të publikuar dhe transmetuar në mënyrë të lirë brenda territorit të tij për qëllime të specifikuar në Konventë.

4. Të gjitha komunikimet zyrtare drejtuar ONAK-ut dhe të gjitha komunikimet zyrtare të jashtme të ONAK-ut, pavarësisht nga mënyra dhe forma e transmetimit, janë të paprekshme. Një paprekshmëri e tillë, pa u kufizuar në këtë radhitje, përfshin: botime, filma, video, regjistrime zëri dhe programe kompjuterike.

#### Neni 5

##### **Përfaqësuesit e shteteve palë**

1. Përfaqësuesit e shteteve palë, së bashku me alternuesit, këshilltarët, ekspertët teknikë dhe sekretaritë e delegacioneve të tyre, në takimet e organizuara nga ONAK-u dhe gjatë udhëtimeve të tyre drejt vendit të takimit dhe anasjelltas, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme, pa cenuar asnjë privilegj dhe imunitet që mund të gëzojnë ndërkohë që ushtrojnë funksionet e tyre dhe gjatë udhëtimeve të tyre drejt vendit të takimit dhe anasjelltas:

a) imunitet ndaj ndalimit dhe arrestimit personal;

b) imunitet nga proceset ligjore të çdo lloji për sa i përket ligjërimit me gojë apo shkrim dhe të gjitha veprimeve të kryera prej tyre, në kapacitetin e tyre zyrtar; një imunitet i tillë vazhdon t'u akordohet pa marrë parasysh se personat në fjalë mund të mos jenë të angazhuar në kryerjen e funksioneve të tilla;

c) paprekshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe materialeve zyrtare;

d) të drejtën për të përdorur kode dhe për të shpërndarë apo marrë gazeta, korrespondencë apo materiale zyrtare me postë apo në zarfe të vulosura;

e) përjashtim, për sa u përket vetë këtyre personave dhe bashkëshortëve të tyre nga kufizimet e emigracionit, regjistrimi i të huajve apo detyrimeve të shërbimeve kombëtare gjatë vizitës apo kalimit në shtetin palë, me qëllim ushtrimin e funksioneve të tyre;



f) të njëjtat mundësi për sa u përket kufizimeve të monedhave apo këmbimit të akorduara, përfaqësuesve të qeverive të huaja me misione të përkohshme zyrtare;

g) të njëjtat imunitete dhe mundësi për sa i përket bagazhit individual të akorduar anëtarëve të misioneve diplomatike të një niveli të krahasueshëm.

2. Nëse vendosja e çdo lloj takse varet nga koha e qëndrimit, periudhat gjatë të cilave personat e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni mund të jenë të pranishëm në territorin e shtetit palë për të kryer detyrat e tyre, nuk konsiderohen si periudha qëndrimi.

3. Privilegjet dhe imunitetet u akordohen personave të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni me qëllim ruajtjen e ushtrimit të pavarur të funksioneve të tyre që lidhen me ONAK-un dhe jo për përfitimin personal të vetë individëve. Mbetet detyrë e të gjithë personave që gëzojnë privilegje dhe imunitete të tilla që të zbatohen në të gjitha aspektet e tjera ligjet dhe rregulloret e shtetit palë.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen për sa i përket personit, i cili ka kombësi të shtetit palë.

## Neni 6 Zyrtarët e ONAK-ut

1. Gjatë kryerjes së aktiviteteve verifikuese, Drejtori i Përgjithshëm dhe stafi i Sekretariatit, përfshirë ekspertët e kualifikuar gjatë hetimeve të përdorimit të supozuar të armëve kimike të përmendura në kapitullin XI, paragrafët 7 dhe 8 të shtojcës të verifikimit të konventës, gëzojnë, sipas nenit VIII paragrafi 51 të Konventës, privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara në kapitullin II seksioni B, të shtojcës të verifikimit të Konventës ose gëzojnë, gjatë kalimit transit nëpër territorin e shteteve palë të painspektuara, privilegjet dhe imunitetet e referuara në kapitullin II paragrafi 12 të së njëjtës shtojcë.

2. Për aktivitete që lidhen me objektin dhe qëllimin e Konventës, zyrtarët e ONAK-ut:

a) gëzojnë imunitet ndaj arrestimit dhe ndalimit personal dhe ndaj konfiskimit të bagazheve të tyre personale;

b) gëzojnë imunitet nga proceset ligjore lidhur me ligjërimin me gojë apo me shkrim dhe të gjitha veprimet e kryera prej tyre gjatë ushtrimit zyrtar të detyrës;

c) gëzojnë paprekshmëri për të gjithë dokumentacionin dhe materialet zyrtare të cilat u nënshtrohen dispozitave të Konventës;

d) gëzojnë të njëjtat përjashtime nga taksat për sa u përket pagave dhe pagesave të kryera nga ONAK dhe me të njëjtat kushte sikundër zyrtarët e Kombeve të Bashkuara;

e) përjashtohen, së bashku me bashkëshortët/et e tyre, nga kufizimet e emigracionit dhe regjistrimi i të huajve;

f) iu ofrohen, së bashku me bashkëshortët/et e tyre, të njëjtat mundësi riatdhesimi në periudha krizash ndërkombëtare, si zyrtarët e të njëjtit nivel të misioneve diplomatike;

g) iu akordohen të njëjtat privilegje për sa u përket lehtësirave të këmbimit valutor si zyrtarët e të njëjtit nivel të misioneve diplomatike.

3. Zyrtarët e ONAK-ut përjashtohen nga detyrimet e shërbimit kombëtar, me kusht që, në raport me shtetasit e shtetit palë, përjashtimi në fjalë të kufizohet vetëm për zyrtarë të ONAK-ut, emrat e të cilëve, për shkak të detyrës së tyre, janë vendosur në një listë të hartuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ONAK-ut dhe të aprovuar nga shteti palë. Në rast se zyrtarë të tjerë të ONAK-ut thirren nga shteti palë për shërbime kombëtare, shteti palë, me kërkesë të ONAK-ut, garanton shtyrje të përkohshme të thirrjeve të zyrtarëve në fjalë, sipas nevojës për të mënjeluar ndërprerje në vazhdimësinë e punës themelore.

4. Përveç privilegjeve dhe imuniteteve të specifikuar në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, Drejtorit të Përgjithshëm të ONAK i akordohen për vete dhe bashkëshorten/bashkëshortin e tij/saj

privilegje, imunitete, përjashtime dhe lehtësira, të cilat u akordohen agjentëve diplomatikë për vete dhe bashkëshorten/bashkëshortin e tyre sipas ligjit ndërkombëtar. Të njëjta privilegje dhe imunitete, përjashtime dhe lehtësira u akordohen, gjithashtu, zyrtarëve të lartë të ONAK-ut, të cilët veprojnë në emër të Drejtorit të Përgjithshëm.

5. Privilegjet dhe imunitetet u garantohen, gjithashtu, zyrtarëve të ONAK-ut në interes të ONAK-ut dhe jo për përfitime personale të vetë individëve. Mbetet detyrë e të gjithë personave të cilët gëzojnë privilegje dhe imunitete të tilla që të zbatojnë në çdo aspekt tjetër ligjet dhe rregulloret e shtetit palë. ONAK gëzon të drejtën dhe detyrën për të hequr imunitetin e çdo zyrtari të ONAK-ut në çdo rast kur, sipas gjykimit të saj, imuniteti do të pengonte dhënien e drejtësisë dhe mund të hiqej pa cenuar interesat e saj/ONAK.

6. ONAK bashkëpunon në çdo moment me autoritetet e duhura të shtetit palë për të lehtësuar zbatimin e duhur të drejtësisë dhe siguron zbatimin e rregullave të policisë dhe parandalon çdo abuzim që lidhet me privilegjet, imunitetet dhe lehtësirat e përmendura në këtë nen.

## Neni 7 Ekspertët

1. Ekspertëve u akordohen privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme, aq sa është e nevojshme për ushtrimin me efikasitet të funksioneve të tyre, përfshirë kohën e harxhuar në udhëtime, që lidhen me detyrat në fjalë:

- a) imunitet ndaj arrestimit apo ndalimit personal dhe nga konfiskimi i bagazheve individuale;
- b) imunitet nga proceset ligjore të çdo lloji, imunitet që vazhdon pavarësisht se personat në fjalë nuk vazhdojnë të kryejnë më funksione zyrtare për ONAK-un, për sa i përket ligjërimit me gojë apo me shkrim apo veprimeve të kryera prej tyre në realizimin e funksioneve të tyre zyrtare;
- c) paprekshmëri e të gjithë dokumentacionit dhe materialeve zyrtare;
- d) të drejtën për të përdorur kode dhe për të marrë korrespondencë me postë apo në zarfe të vulosura për qëllime të komunikimeve të tyre me ONAK-un;
- e) të njëjta lehtësira, për sa u përket kufizimeve të monedhës dhe këmbimit valutor siç u akordohen përfaqësuesve të qeverive të huaja me misione zyrtare të përkohshme;
- f) të njëjta imunitete dhe lehtësira, për sa u përket bagazheve personale, siç u akordohet anëtarëve të një niveli të njëjtë të misioneve diplomatike.

2. Privilegjet dhe imunitetet u akordohen ekspertëve në interes të ONAK-ut dhe jo për përfitime personale të vetë individëve. Mbetet detyrë e të gjithë personave që gëzojnë privilegje dhe imunitete të tilla për të vëzhguar në të gjitha aspektet e tjera ligjet dhe rregulloret e shtetit palë. ONAK gëzon të drejtën dhe detyrën për t'i hequr imunitetin çdo eksperti në secilin rast kur, sipas mendimit të saj, imuniteti do të pengonte zbatimin e drejtësisë dhe mund t'i hiqet pa dëmtuar interesat e ONAK-ut.

## Neni 8 Shpërdorimi i privilegjit

1. Nëse shteti palë gjykon se ka ndodhur një shpërdorim i privilegjit apo imunitetit të akorduar nga kjo marrëveshje, kryhen konsultime ndërmjet Shtetit Palë dhe ONAK-ut për të përcaktuar nëse shpërdorimi në fjalë ka ndodhur dhe, nëse po, të bëjnë përpjekje për të garantuar mospërsëritjen e tij. Në rast se konsultimet e lartpërmendura nuk arrijnë një rezultat të kënaqshëm për shtetin palë dhe ONAK-un, çështja nëse një shpërdorim i privilegjit apo imunitetit ka ndodhur apo jo zgjidhet me anë të një procedure sipas nenit 10.

2. Personave të përfshirë në një nga kategoritë sipas neneve 6 dhe 7 nuk u kërkohet nga autoritetet territoriale të largohen nga shteti palë për shkak të asnjë veprimtarie të kryer prej tyre në



funksionet zyrtare. Megjithatë, në rastin e shpërdorimit të privilegjeve nga çdo person në aktivitete jashtë funksioneve zyrtare, personit mund t'i kërkohet nga qeveria e shtetit palë të largohet, me kusht që urdhri i largimit nga vendi të jetë lëshuar nga ana e autoriteteve territoriale me miratim të Ministrisë të Jashtëm të shtetit palë. Miratimi në fjalë jepet vetëm mbas konsultimit me Drejtorin e Përgjithshëm të ONAK-ut. Nëse ndaj personit mbahen seanca dëbimi, Drejtori i Përgjithshëm i ONAK-ut gëzon të drejtën për të marrë pjesë në seanca të tilla në emër të personit ndaj të cilit ato kanë filluar.

#### Neni 9

##### **Dokumentacioni i udhëtimit dhe vizat**

1. Shteti Palë njeh dhe pranon si të vlefshme pasaportat e emergjencës të lëshuara zyrtarëve të ONAK-ut, sipas marrëveshjeve të veçanta të ONAK-ut, me qëllim kryerjen e detyrave të tyre që lidhen me konventën. Drejtori i Përgjithshëm njofton shtetin palë mbi marrëveshjet përkatëse të ONAK-ut.

2. Shteti Palë ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar hyrjen dhe qëndrimin në territorin e tij dhe nuk vendos asnjë pengesë gjatë largimit nga territori i tij i personave të përfshirë në një nga kategoritë sipas neneve 5, 6 dhe 7 më sipër, pavarësisht kombësisë së tyre, dhe garanton që asnjë pengesë të mos vendoset gjatë kalimit transit të tyre drejt vendit ku kryejnë funksione zyrtare dhe në kthim, dhe u siguron çdo mbrojtje të nevojshme gjatë kalimit transit.

3. Aplikimet për viza dhe viza transit, kur nevojitet, të personave të përfshirë në një nga kategoritë sipas neneve 5, 6 dhe 7, kur shoqërohen me një vërtetim që përcakton udhëtimin për qëllime zyrtare, trajtohen sa më shpejt që të jetë e mundur për të lejuar personat në fjalë të kryejnë në mënyrë të efektshme funksionet e tyre. Për më tepër, personave në fjalë u sigurohen mundësi për udhëtim të shpejtë.

4. Drejtori i Përgjithshëm dhe zëvendës-drejtori(ët) e përgjithshëm dhe zyrtarët e tjerë të ONAK-ut, të cilët udhëtojnë me funksione zyrtare, u akordohen lehtësira udhëtimi të barabarta me anëtarët e të njëjtit nivel të misionëve diplomatike.

5. Për kryerjen e aktiviteteve verifikuese, vizat lëshohen në përputhje me paragrafin 10 të kapitullit II seksioni B të shtojcës së verifikimit të konventës.

#### Neni 10

##### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. ONAK parashikon metoda të përshtatshme për zgjidhjen e:

a) mosmarrëveshjeve që dalin nga kontratat ose mosmarrëveshjet e tjera të karakterit ligjor privat në të cilat ONAK është palë;

b) mosmarrëveshjet që përfshijnë çdo zyrtar të ONAK-ut apo ekspert i cili, për shkak të pozitës së tij zyrtare, gëzon imunitet dhe nëse imuniteti në fjalë është hequr në përputhje me nenin 6, paragrafi 5 ose neni 7, paragrafi 2 të kësaj marrëveshjeje.

2. Çdo mosmarrëveshje që lidhet me interpretimin ose aplikimin e kësaj marrëveshjeje, që nuk zgjidhet në mënyrë miqësore, i referohet për një vendim përfundimtar një gjykatë prej tre gjyqtarësh me kërkesë të secilës palë në mosmarrëveshje. Secila palë emëron një gjyqtar. I treti, i cili është edhe kryetari i gjyqit, zgjidhet nga dy gjyqtarët e tjerë.

3. Nëse një nga palët dështon në emërimin e një gjyqtari dhe nuk ka ndërmarrë hapa për ta bërë një gjë të tillë brenda dy muajve nga kërkesa e palës tjetër për emërimin në fjalë, pala tjetër mund t'i kërkojë Presidentit të Gjykatës së Drejtësisë që të kryejë një emërim të tillë.

4. Nëse dy gjyqtarët e parë nuk arrijnë të bien dakord mbi gjyqtarin e tretë brenda dy muajve nga emërimi i tyre, secila palë mund t'i drejtohet Presidentit të Gjykatës së Drejtësisë që të kryejë një emërim të tillë.

5. Gjykata kryen seancat e saj në përputhje me rregulloret opsionale të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit për Arbitrazh, që përfshin organizatat dhe shtetet ndërkombëtare aktualisht në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

6. Gjykata merr vendimin e saj me shumicë votash. Një vendim i tillë mbetet përfundimtar dhe detyrues për palët në mosmarrëveshje.

#### Neni 11 Interpretimi

1. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje interpretohen në dritën e funksioneve të cilat konventa ia beson ONAK-ut.

2. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk kufizojnë apo cenojnë në asnjë mënyrë privilegjet dhe imunitetet e akorduara anëtarëve të ekipit të inspektimit në kapitullin II seksioni B të shtojcës së verifikimit të konventës ose privilegjet dhe imunitetet e akorduara Drejtorit të Përgjithshëm dhe stafit të Sekretariatit të ONAK-ut në nenin VIII, paragrafi 51 i konventës. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk veprojnë më vete, në mënyrë që të shfuqizojnë apo kufizojnë ndonjë nga dispozitat e Konventës ose çdo të drejtë apo detyrim që ONAK aktualisht gëzon, i ka përfituar apo i ka marrë përsipër.

#### Neni 12 Dispozita përfundimtare

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e depozitimit pranë Drejtorit të Përgjithshëm të instrumentit të ratifikimit të shtetit palë. Kuptohet që në momentin kur instrumenti i ratifikimit depozitohet nga ana e shtetit palë, i përket statusit të legjislacionit të tij për të vlerësuar kushtet e kësaj marrëveshjeje.

2. Kjo marrëveshje vazhdon të jetë në fuqi për sa kohë që shteti palë mbetet palë e konventës.

3. ONAK dhe shteti palë mund të lidhin marrëveshje plotësuese sipas nevojës.

4. Konsultimet për sa i përket amendimit të kësaj marrëveshjeje realizohen me kërkesë të ONAK-ut dhe shtetit palë. Çdo amendim i tillë arrihet me pëlqim të përbashkët të shprehur në një marrëveshje të konkluduar nga ONAK-u dhe shteti palë.

Bërë në Hagë në dy kopje më ....., në gjuhën angleze.

PËR ORGANIZATËN E NDALIMIT TË  
ARMËVE KIMIKE

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

\_\_\_\_\_  
**Ahmet Uzumcu**  
Drejtor i Përgjithshëm



**LIGJ**  
**Nr. 14/2012**

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9693, DATË 19.3.2007 “PËR  
FONDIN KULLOSOR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

**Neni 1**

Në nenin 10 bëhet ndryshimi dhe shtesat si më poshtë:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Pjesë të fondit kullosor kombëtar kthehen në kategorinë e resursit të tokës bujqësore me kërkesën e pronarit apo organit të qeverisjes vendore i cili e ka në pronësi këtë fond. Ndryshimi i formës së përdorimit të fondit kullosor në kategorinë e resursit të tokës bujqësore, pavarësisht nga madhësia e sipërfaqes, bëhet vetëm për mbjelljen e këtyre sipërfaqeve me kultura të drurëve, të cilët janë pjesë e programeve dhe politikave parësore shtetërore afatgjata.”.

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 2/1 dhe 2/2 me këtë përmbajtje:

“2/1. Kërkesa për kalimin e pjesëve të fondit kullosor në kategorinë e resursit të tokës bujqësore paraqitet në komunën dhe/ose bashkinë, në territorin e së cilës ndodhet fondi kullosor, që shqyrtohet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionet e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar.

2/2. Kalimi i resursit të tokës së pafrytshme, që është në pronësi private apo të organeve të qeverisjes vendore, në fond kullosor (kullotë, livadh), dhe regjistrimi në kadastrën kombëtare të fondit kullosor bëhen me kërkesë të pronarit apo organit të qeverisjes vendore. Kërkesa paraqitet pranë ministrisë që mbulon pyjet dhe miratohet nga ministri përkatës.”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.2.2012

**Shpallur me dekretin nr.7305, datë 6.3.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr. 15/2012**

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9385, DATË 4.5.2005 “PËR PYJET  
DHE SHËRBIMIN PYJOR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

1. Në nenin 17 bëhet ndryshimi dhe shtesat si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Pjesë të fondit pyjor kombëtar, që kërkohen nga subjekte juridike ose fizike apo nga organet e qeverisjes vendore, për t’u kthyer në truall, për zgjerimin e vijës kufizuese të ndërtimit dhe të shtrirjes territoriale të periferisë së qytetit e të qendrave të banuara në zonat rurale, për ndërtimin e strukturave turistike, të qendrave të pushimit apo ato shëndetësore ose për qëllime të tjera publike, për rrugë automobilistike apo hekurudhore, për shpim dhe shfrytëzim të puseve të naftës e të gazit, për veprimtari minerare e gjeologjike, për aeroporte dhe struktura të telekomunikacionit, për qëllime të strukturave ushtarake, qendra industriale, hiqen nga fondi pyjor dhe nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve, si më poshtë:

a) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri në 1 ha, me miratimin e ministrit;

b) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe mbi 1 ha e deri në 100 ha, me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe mbi 100 ha, me ligj të veçantë.”.

2. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1 dhe 1/2 me këtë përmbajtje:

“1/1. Pjesë të fondit pyjor kombëtar kthehen në kategorinë e resursit të tokës bujqësore, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionet e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar. Ndryshimi i formës së përdorimit të fondit pyjor në kategorinë e resursit të tokës bujqësore, pavarësisht madhësisë së sipërfaqes, bëhet vetëm për mbjelljen e këtyre sipërfaqeve me kultura të drurëve, të cilët janë pjesë e programeve dhe të politikave prioritare shtetërore afatgjata.

1/2. Kalimi i resursit të tokës së pafrytshme, që është në pronësi private apo të organeve të qeverisjes vendore, në fond pyjor, (pyll), dhe regjistrimi në Kadastrën Kombëtare të Pyjeve, bëhet me kërkesë të pronarit apo organit të qeverisjes vendore. Kërkesa paraqitet pranë ministrisë veprimtaria e së cilës mbulon pyjet, dhe miratohet nga ministri përkatës.”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.2.2012

**Shpallur me dekretin nr.7306, datë 6.3.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**



**LIGJ**  
**Nr. 16/2012**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8752, DATË 26.3.2001 “PËR  
KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE PËR ADMINISTRIMIN DHE  
MBROJTJEN E TOKËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Në nenin 11/1 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Miratimi i ndryshimit të kategorisë së resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë dhe livadh dhe kalimi i tyre në kategorinë e resursit tokë bujqësore bëhet nga komisioni që krijohet pranë komunës ose bashkisë, i cili kryesohet nga kryetari i komunës ose bashkisë dhe që ka në përbërje këta anëtarë:

- a) një përfaqësues të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë (DRB);
- b) një përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor (DSHP);
- c) një përfaqësues të Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës(DAMT) të qarkut;
- ç) përgjegjës in e Zyrës së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës (ZMMT);
- d) juristin e komunës dhe/ose bashkisë.

2. Pas pikës 4 shtohen pikat 4/1, 4/2, 4/3, 4/4 dhe 4/5 me këtë përmbajtje:

“4/1. Kërkesa për ndryshim të kategorive të resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë dhe livadh, në kategorinë e resursit tokë bujqësore, sipas pikës 4 të këtij neni, kur kategoritë që kërkohet të ndryshohen janë në pronësi private, bëhet vetëm nga pronarët e tyre, ndërsa kur janë në pronësi të komunës ose bashkisë, kërkesa në komision paraqitet nga ZMMT-ja e njesisë së qeverisjes vendore.

Fondi i tokës bujqësore i krijuar nga ndryshimi i kategorive të resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë dhe livadh që janë në pronësi të komunave dhe bashkive, administrohet sipas legjislacionit në fuqi për tokat bujqësore të pandara.

4/2. Ndryshimi i kategorive të resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë dhe livadh, në kategori të resursit tokë bujqësore, sipas pikës 4 të këtij neni, ndërmerret vetëm kur paraqiten projekte zhvillimi afatgjata të kulturave bujqësore, që përputhen me programet mbështetëse të qeverisë.

4/3. Kryetari i komunës ose bashkisë detyrohet të mbledhë komisionin dhe të shqyrtojë kërkesat për ndryshim të kategorive të resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë dhe livadh, në kategorinë e resursit tokë bujqësore, sipas pikës 4 të këtij neni, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e regjistrimit të tyre.

4/4. Subjekti që ka paraqitur kërkesë për ndryshim të kategorive të resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë dhe livadh, në kategorinë e resursit tokë bujqësore, sipas pikës 4 të këtij neni, kur komisioni rrëzon kërkesën e paraqitur ose nuk e shqyrton atë brenda afatit të përcaktuar, ka të drejtë ta paraqesë këtë kërkesë për vendimmarrje në ministritë, veprimtaria e të cilave mbulon këto kategori resursesh.”.



4/5. Ndryshimi i kategorisë së resursit tokë bujqësore në kategoritë e resurseve pyll, kullotë dhe livadh bëhet vetëm me kërkesë të pronarit të saj apo organit të qeverisjes vendore, i cili i ka në përdorim këto toka. Kërkesa për ndryshimin paraqitet pranë ministrisë, veprimtaria e së cilës mbulon këtë kategori resursi. Miratimi i ndryshimit bëhet:

- a) për sipërfaqet deri në 5 ha, me urdhër të ministrit përkatës;
- b) për sipërfaqet mbi 5 ha, me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

3. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Ndryshimi i tokës së pafrytshme në kategorinë e resursit tokë bujqësore bëhet vetëm me kërkesë të pronarit të saj apo të organit të qeverisjes vendore, i cili e ka në pronësi ose në përdorim këtë resurs, dhe miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.

4. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

“5/1. Ndryshimi i tokës bujqësore në kategorinë e resursit tokë e pafrytshme, kur mbi këto sipërfaqe dokumentohet se kanë ndikuar faktorë natyrorë të fuqisë madhore, bëhet vetëm me kërkesë të pronarit të saj apo organit të qeverisjes vendore i cili e ka në përdorim këtë resurs. Kërkesa për ndryshim paraqitet pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Miratimi i ndryshimit bëhet:

- a) për sipërfaqet deri në 5 ha, me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- b) për sipërfaqet mbi 5 ha, me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

5. Në pikën 6, fjalët “sipas pikave 1 deri në 5 të këtij neni” zëvendësohen me fjalët “sipas pikave 1 deri në 5/1 të këtij neni”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.2.2012

**Shpallur me dekretin nr.7307, datë 6.3.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ  
Nr. 17/2012**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7850, DATË 29.7.1994 “KODI  
CIVIL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 81 pika 2 shkronja “d” dhe të nenit 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:



## Neni 1

Në nenin 115, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) një vit paditë për shpërblimin e dëmit jopasuror për cenimin e nderit, personalitetit ose reputacionit.”.

## Neni 2

Neni 625 ndryshohet si më poshtë vijon:

### “Neni 625

Personi që pëson një dëm jopasuror ka të drejtë të shpërblehet kur:

- a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit, të integritetit fizik ose psikik të tij;
- b) është cenuar nderi, personaliteti ose reputacioni i tij;
- c) është cenuar drejta e emrit;
- ç) është cenuar respektimi i jetës private;
- d) është cenuar kujtimi i një të vdecuri. Në këtë rast bashkëshorti i personit të vdekur ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë mund të kërkojnë shpërblimin e dëmit jopasuror.”.

## Neni 3

Pas nenit 647 shtohet neni 647/a me këtë përmbajtje:

### “Neni 647/a

#### **Mënyra dhe kriteret e caktimit të përgjegjësisë civile dhe të masës së dëmit jopasuror**

Shpërblimi i dëmit jopasuror për cenimin e nderit, personalitetit ose reputacionit të personit, synon rivendosjen e të drejtës së shkelur, në mënyrë proporcionale me dëmin e pësuar dhe caktohet në bazë të rrethanave të çështjes. Për përcaktimin e përgjegjësisë civile dhe masës së dëmit jopasuror, gjykata mban parasysh edhe:

- a) mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve;
- b) shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve;
- c) format dhe shkallën e fajësisë;
- ç) faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë;
- d) faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit;
- dh) faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik;
- e) faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme;
- ë) faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje;
- f) kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar;
- g) faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi;

gj) faktin nëse dëmspërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit.”.

Neni 4

Për çështjet civile me objekt shpërblimin e dëmit jopasuror ndaj reputacionit, që janë ende në proces në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohet legjislacioni civil në fuqi, në kohën e ngritjes së padive për shpërblimin e dëmit jopasuror.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.2.2012

**Shpallur me dekretin nr.7308, datë 6.3.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ  
Nr. 18/2012**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË  
PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË  
PËR LËVIZJEN E NDËRSJELLË TË SHTETASVE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për ndryshimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve, nënshkruar më 19 shkurt 2008.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.2.2012

**Shpallur me dekretin nr.7331, datë 8.3.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**



## MARRËVESHJE

### NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR LËVIZJEN E NDËRSJELLË TË SHTETASVE, TË NËNSHKRUAR MË 19 SHKURT 2008

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë (më tej të referuara si “Palët”),

*me dëshirën* për të thelluar më tej marrëdhëniet dypalëshe dhe bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë;

*në përputhje* me nenin 12 të marrëveshjes për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë të nënshkruar më 19 shkurt 2008;

*me qëllim* për të lehtësuar më tej regjimin e lëvizjes së ndërsjellë të shtetasve të Palëve, kanë rënë dakord që marrëveshja për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, e cila ka hyrë në fuqi nga 27 gushti 2008, të ndryshohet si vijon.

#### Neni 1

Në nenin 1, paragrafi 1, fjala “ose” që ndjek fjalën “shërbimi”, do të zëvendësohet me fjalën “dhe” dhe fjalët “karta identiteti biometrike të vlefshme” do të shtohen pas fjalëve “pasaporta kombëtare”.

Në të njëjtin nen, paragrafi 2, fjalët “ose karta identiteti biometrike të vlefshme” do të shtohen pas fjalëve “dokumente udhëtimi”.

#### Neni 2

Në nenin 4, fjalët “një periudhë më e gjatë kohe” do të hiqen dhe fjalët “për më tepër se 90 ditë brenda një periudhe prej 180 ditësh” do të shtohen pas fjalëve “në territorin e Palës tjetër Kontraktuese”.

#### Neni 3

Në nenin 9, një presje dhe fjalët “kartë identiteti biometrike” do të shtohen pas fjalëve “dokumente të përshtatshme udhëtimi”.

#### Neni 4

Në nenin 10, paragrafi 1, fjalët “dhe kartë identiteti biometrike e vlefshme” do të shtohen pas fjalëve “dokumente udhëtimi të vlefshme”.

Në të njëjtin nen, paragrafi 2, fjalët “ose karta identiteti biometrike” do të shtohen pas fjalëve “një model i ri i dokumentit të udhëtimit”.

#### Neni 5

Në pikën 1 të shtojcës së marrëveshjes të shtohet teksti: “h) karta identiteti biometrike” pas pikës “g”.

Në pikën 2 të shtojcës të shtohet teksti: “g) kartë identiteti biometrike” pas pikës “f”.

Neni 6

Kjo marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë që ndryshon Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë mbi lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve, e nënshkruar në Tiranë më 19 shkurt 2008, do të hyjë në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, ku palët informojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike se janë plotësuar kushtet ligjore për hyrjen në fuqi.

Bërë në Tiranë, më 14.12.2011, në dy kopje origjinale në gjuhët shqipe, maqedonase, angleze, të gjitha tekstet të vlefshme në mënyrë të barabartë. Në rast të mospërputhjeve në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

**LIGJ**  
**Nr. 19/2012**

**PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT TË MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI  
PËR LËVIZJEN E NDËRSJELLË TË SHTETASVE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi i marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.2.2012

**Shpallur me dekretin nr.7332, datë 8.3.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**



## **NDRYSHIMI I MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI MBI LËVIZJEN E NDËRSJELLË TË SHTETASVE**

Palët kontraktuese, me dëshirën për të lehtësuar lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve të tyre, mbështetur në nenin 10 të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi mbi lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve, të nënshkruar më 6.11.2009, kanë rënë dakord për ndryshimet e mëposhtme:

### Neni 1

Dokumente të vlefshme për qëllimet e kësaj marrëveshjeje do të konsiderohen:

1.1 Të zbatueshme për shtetasit e Republikës së Shqipërisë:

- a) pasaporta;
- b) pasaporta diplomatike;
- c) pasaporta e shërbimit;
- d) dokument i vlefshëm udhëtimi për kthim në Republikën e Shqipërisë;
- e) dokumente udhëtimi të lëshuara në përputhje me të drejtën ndërkombëtare të zbatueshme nga palët kontraktuese;
- f) karta e identitetit biometrike (për qëndrim deri në 30 ditë brenda 180 ditëve).

1.2 Të zbatueshme për shtetasit e Malit të Zi:

- a) pasaporta;
- b) pasaporta diplomatike;
- c) pasaporta e shërbimit;
- d) dokument i vlefshëm udhëtimi për kthim në Malin e Zi;
- e) dokumente udhëtimi të lëshuara në përputhje me të drejtën ndërkombëtare të zbatueshme nga palët kontraktuese;
- f) karta e identitetit biometrike (për qëndrim deri në 30 ditë brenda 180 ditëve).

### Neni 2

Këto ndryshime do të hyjnë në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të fundit me anë të të cilit Palët Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike, njoftojnë njëra-tjetrën për përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të tyre.

Bërë në Tiranë, më 14.12.2011, në dy ekzemplarë në gjuhët shqipe, malazeze dhe angleze, ku të gjitha tekstet kanë vlerë të njëjtë. Në rast interpretimi të ndryshëm të këtyre dispozitave, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

## **VENDIM Nr. 12/2012**

### **PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 3, DATË 16.9.2009 “PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të neneve 55 pika 1 dhe 21 pikat 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, pas marrëveshjes së Kryetares së Kuvendit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

- I. Deputeti Ilir Meta caktohet anëtar në Komisionin për Integrimin Europian.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 23.2.2012

VENDIM  
Nr.7, datë 27.2.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	anëtar	i	“	“
Petrit Ploçi	anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	anëtare	e	“	“
Sokol Berberi	anëtar	i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare	e	“	“
Admir Thanza	anëtar	i	“	“

me sekretare Enina Mullaj, në datën 11.10.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen nr. 38/14 akti, që i përket:

KËRKUES: Harallamb Kulo, përfaqësuar nga avokat Trifon Toska me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Ministria e Drejtësisë, e përfaqësuar me autorizim nga Marsida Xhaferllari dhe Gentian Jahjoli.

Zyra e Shërbimit Përmbartimor pranë Rrethit Gjyqësor Tiranë, në mungesë.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1, 131/f, 132/1, 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27 dhe 28 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Admir Thanza, përfaqësuesin e kërkuarit që u shpreh për pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjektit të interesuar, Ministrisë së Drejtësisë, të cilët kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,



## VËREN:

### I

#### *Rrethanat e çështjes*

1. Kërkuesi ka punuar në Ministrinë e Drejtësisë në detyrën e përgjegjës në Sektorin e Kontrollit Gjyqësor në Drejtorinë e Inspektimit, detyrë të cilën e ka kryer deri në daljen e aktit administrativ nr. 1894/1, datë 27.3.2006, të Drejtores së Inspektimit, me anë të të cilit ndaj tij është dhënë masa disiplinore “Largim nga shërbimi civil”.

2. Kërkuesi ka kundërshtuar aktin administrativ të lartpërmendur në Komisionin e Shërbimit Civil (KSHC).

3. KSHC, me vendimin nr. 552, datë 12.7.2006, ka vendosur pranimin e pjeshëm të ankesës të z. Harallamb Kulo, duke ndryshuar masën disiplinore nga “Largim nga shërbimi civil” në “Kalim në një detyrë të një niveli apo klasë më të ulët” për një periudhë kohe prej 6 (gjashtë) muajsh, duke urdhëruar kthimin e kërkuesit në vendin e mëparshëm të punës dhe pagimin e pagës nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në ekzekutimin e vendimit.

4. Ministria e Drejtësisë ka kundërshtuar vendimin e KSHC-së duke kërkuar shfuqizimin e tij dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 1894/1, datë 27.3.2006 të Drejtores së Inspektimit.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendim nr. 159, datë 3.5.2007, ka vendosur rrëzimin e padisë së Ministrisë së Drejtësisë për shkak të paraqitjes së saj jashtë afatit të parashikuar në ligj.

6. Po ashtu, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.46, datë 31.3.2008, me kërkesë të z. Harallamb Kulo, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 159, datë 3.5.2007, si titull ekzekutiv.

7. Kundër vendimit nr. 159, datë 3.5.2007, të Gjykatës së Apelit Tiranë, Ministria e Drejtësisë ka paraqitur recurs.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, me vendimin nr. 00-2008-915, datë 15.9.2008, ka vendosur mospranimin e recursit të paraqitur nga Ministria e Drejtësisë, pasi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

9. Pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, vendimit nr. 46, datë 31.3.2008, nga Gjykata e Apelit Tiranë, kërkuesi me shkresë më datë 10.6.2008 i është drejtuar Zyrës së Përmbaramit Tiranë për ekzekutimin e vendimit.

10. Zyra e Përmbaramit Tiranë, me shkresë nr. 543/Sh, prot. nr. 7799, datë 16.6.2008, i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë për ekzekutimin vullnetar të vendimit.

11. Po ashtu, kërkuesi me kërkesë datë 23.12.2008, pas përfundimit të gjykimit edhe në Gjykatën e Lartë, i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë nr. 159, datë 3.5.2007, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

12. Me shkresë nr. 5661, datë 8.7.2009, Ministri i Drejtësisë i është drejtuar Kryetarit të Zyrës së Përmbaramit Tiranë, duke arsyetuar se vendimi gjyqësor nr. 159, datë 3.5.2007, i Gjykatës së Apelit Tiranë, nuk ka ngarkuar me ndonjë detyrim konkret Ministrinë e Drejtësisë e si i tillë, nuk mund të vihet në ekzekutim nga kjo Ministri.

### II

#### *Pretendimet e palëve të parashtruara Gjykatës Kushtetuese*

13. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji, në kuptimin e nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së. Ai ka parashtruar se ka hasur në refuzimin dhe pasivitetin e organeve kompetente (Ministria e



Drejtësisë dhe Zyra e Përmbartimit Tiranë) për të ekzekutuar vendimin e formës së prerë. Gjatë seancës gjyqësore, kërkuesi, po ashtu, ka saktësuar se pretendon ekzekutimin e vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Tiranë vetëm në lidhje me pagimin e pagës nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në ekzekutimin e vendimit, duke hequr dorë nga ekzekutimi i pjesës tjetër të vendimit për rikthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës, pasi ka mbushur moshën e daljes në pension dhe, për pasojë, kjo pjesë e vendimit nuk mund të ekzekutohet më.

14. *Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë*, gjatë gjykimit parashtrori në mënyrë të përmbledhur këto prapësime:

14.1. Kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, pasi ai nuk ka arritur të provojë lidhjen e kërkesës me interesat e tij, pra nuk ka arritur të argumentojë nëse justifikohet interesi i tij për çështjen objekt shqyrtimi. Kjo sepse, sipas subjektit të interesuar, cenimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor nuk ka ardhur si rezultat i sjelljes dhe vullnetit të Ministrisë së Drejtësisë. Gjithashtu, duke qenë se Gjykata e Apelit ka rrëzuar kërkesën e kësaj të fundit pa shqyrtim gjyqësor të fakteve dhe rekursi nuk është pranuar nga Gjykata e Lartë, e drejta e aksesit për Ministrinë e Drejtësisë nuk është respektuar. Për pasojë, vendimi objekt shqyrtimi nuk është rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor dhe nuk mund të merret në mbrojtje nga neni 131/f i Kushtetutës.

14.2. Po ashtu, kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, pasi ai nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion për këtë qëllim. Sipas subjektit të interesuar, kërkuesi për mospërmbushjen e së drejtës së fituar duhet t'i drejtohet sistemit të zakonshëm gjyqësor dhe jo Gjykatës Kushtetuese. Gjykatat e sistemit të zakonshëm duhet të përcaktojnë saktësisht detyrimin e debitorit në mënyrë që ai të jetë i ekzekutuueshëm.

14.3. Vendimi nr. 159, datë 3.5.2007 i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrjedhimisht, vendimi nr. 46, datë 31.8.2008 i Gjykatës së Apelit Tiranë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv, nuk është titull ekzekutiv, pasi ai nuk përcakton asnjë detyrim konkret dhe të plotë për debitorin. Për këtë arsye, kërkuesi duhet t'i drejtohet gjykatave të zakonshme për detyrimin e debitorit me qëllim ekzekutimin e vendimit të KSHC-së.

14.4. Objekti i kërkesës është mosekzekutimi i një vendimi, ndaj të cilit janë verifikuar fakte të reja që e bëjnë objektivisht të pamundur ekzekutimin e tij në pjesën e rikthimit të kërkuesit në vendin e mëparshëm të punës. Kjo pasi rezulton se aktualisht kërkuesi ka mbushur moshën e daljes në pension.

14.5. Kthimi në punë i kërkuesit, si pjesë e vendimit gjyqësor që kërkohet të ekzekutohet, është i pamundur pasi struktura e Drejtorisë së Inspektimit Gjyqësor, për shkak të procesit të reformimit, përbëhet nga gjithsej 7 persona dhe aktualisht ky sektor nuk ka vende të lira në dispozicion. Ky fakt ka justifikuar vonesën e subjektit të interesuar në ekzekutimin e vendimit. Gjithashtu, periudha nga e cila duhet të fillojë të përlllogaritet afati i arsyeshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, sipas subjektit të interesuar, është data kur ka përfunduar çështja në Gjykatën e Lartë (15.9.2008), përndryshe, ky i fundit do të penalizohej për faktin që ka ushtruar të drejtën e mbrojtjes.

14.6. Akti i emërimit të kërkuesit, për shkak të detyrës dhe funksioneve të tij si një funksionar publik, është një akt tipik i së drejtës administrative. Për pasojë, sipas subjektit të interesuar, procedurat e lidhura me ekzekutimin e vendimit të KSHC-së janë krejtësisht administrative dhe nuk mund të cilësohen si procedura që përcaktojnë një të drejtë me karakter civil sipas nenit 6/1 të KEDNJ-së. Pra, pretendimet e kërkuesit janë jashtë fushës së veprimtimit të nenit 6/1 të KEDNJ-së.



### III

#### *Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese*

15. Gjykata Kushtetuese, përpara se të analizojë themelin e kërkesës, vlerëson të nevojshme të ndalet fillimisht te pretendimet e përfaqësuesit të subjektit të interesuar, Ministrisë së Drejtësisë, për sa i takon legjitimitet të kërkuarit para kësaj Gjykate, më pas pretendimit për ekzistencën ose jo të titullit ekzekutiv dhe së fundmi pretendimit mbi karakterin civil ose jo të çështjes objekt shqyrtimi.

#### *A. Lidhur me legjitimitetin e kërkuarit*

16. Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, pretendon se kërkuari nuk legjitimohet në kërkesën e tij, pasi ai nuk ka arritur të justifikojë interesin për çështjen objekt shqyrtimi. Kjo sepse, sipas subjektit të interesuar, interesi i një subjekti në një çështje, në kuptim të nenit 134/2 të Kushtetutës, është i justifikuar kur pasoja është e drejtpërdrejtë, pra rrjedh nga akti objekt shqyrtimi; është aktuale dhe është e lidhur ngushtë me të drejtën e pretenduar. Ndërsa në rastin konkret cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor nuk ka ardhur si rezultat i sjelljes dhe vullnetit të Ministrisë së Drejtësisë. Gjithashtu, duke qenë se gjykata e apelit ka rrëzuar kërkesën e kësaj të fundit pa shqyrtim gjyqësor të fakteve dhe rekursi nuk është pranuar nga Gjykata e Lartë, e drejta e aksesit për Ministrinë e Drejtësisë nuk është respektuar. Për pasojë, vendimi objekt shqyrtimi nuk është rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor që të merret në mbrojtje nga neni 131/f i Kushtetutës.

17. Gjykata Kushtetuese çmon se kërkuari ka argumentuar qartë lidhjen e kërkesës me interesat e tij. Ka qenë vullneti dhe sjellja e subjektit të interesuar, të shprehura haptazi, për të mos vënë në ekzekutim aktin objekt shqyrtimi, që ka passjellë cenimin e të drejtës së kërkuarit për një proces të rregullt ligjor në drejtim të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Gjithsesi, mbi këto argumente Gjykata Kushtetuese do të ndalet më hollësisht më poshtë.

18. I pabazuar është edhe pretendimi i Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me mohimin e të drejtës së saj të aksesit. Gjykata Kushtetuese në këtë aspekt thekson se Kushtetuta ka parashikuar mjete të posaçme për këtë qëllim, që duhet të përdoren në momentin e duhur dhe të përcaktuar me ligj nga çdo subjekt që pretendon se i janë cenuar të drejtat e tij kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

19. Po ashtu, Ministria e Drejtësisë ka parashtruar se kërkuari nuk i ka shteruar të gjitha mjetet ligjore të ankimit, si kusht për t'iu drejtuar Gjykatës. Këtë pretendim e mbështet në argumentin se nuk ka ende një vendim përfundimtar, duke qenë se vendimi i Gjykatës së Apelit për lëshimin e urdhrit ekzekutiv nuk është i qartë dhe i plotë. Për këtë arsye, kërkuari duhet t'i drejtohej përsëri gjykatës së shkallës së parë për të kërkuar detyrimin e debitorit të paguajë shumën e caktuar ndaj kreditorit.

20. Gjykata Kushtetuese çmon se, ndryshe nga pretendimi i subjektit të interesuar, kërkuari legjitimohet në kërkesën e tij drejtuar kësaj Gjykate.

21. Kërkuari, në bazë të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", i është drejtuar KSHC-së dhe ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të Ministrit të Drejtësisë për largimin e tij nga puna. KSHC-ja ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës, duke ndryshuar masën disiplinore nga "Largim nga shërbimi civil" në "Kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët" për një periudhë kohe prej 6 (gjashtë) muaj, duke urdhëruar kthimin e kërkuarit në vendin e mëparshëm të punës dhe pagimin e pagës nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në ekzekutimin e vendimit. Sipas ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën e Apelit, gjë të cilën e ka bërë subjekti i interesuar. Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e KSHC-së. Rekursi i ushtruar në Gjykatën e Lartë nga Ministria e Drejtësisë është rrëzuar.

22. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë për të lëshuar urdhrin me qëllim ekzekutimin e vendimit të KSHC-së. Pas vendimit të Gjykatës së Apelit për lëshimin e urdhrit ekzekutiv, kërkuesi i është drejtuar Zyrës së Shërbimit Përmbartimor Tiranë, për ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Kjo e fundit ka nxjerrë vendimin për ekzekutimin vullnetar nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, e cila nuk ka pranuar të ekzekutojë asnjë pjesë të detyrimit.

23. Gjykata vlerëson se është i pabazë argumenti i Ministrisë së Drejtësisë se kërkuesi duhej t'i ishte drejtuar Gjykatës së Shkallë së Parë për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor. Nuk është detyrimi i kreditorit që të hapë një proces të ri gjyqësor, nga i cili rrjedhimisht do të dalë një vendim tjetër gjyqësor për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të dhënë më parë. Gjykata thekson se vendimi për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit ka në thelb të tij jo konfirmimin e detyrimit të debitorit, por fillimin e procesit të ekzekutimit dhe vënien në lëvizje të organit kompetent për këtë qëllim. Në këtë aspekt, nuk ka arsye që pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, i cili ka vënë në lëvizje përmbartimin, kreditori t'i drejtohet përsëri gjykatës për të kërkuar detyrimin e debitorit për të shlyer detyrimin ndaj tij.

24. Për sa më lart, Gjykata Kushtetuese, nisur nga fakti se nuk ka mjet tjetër të parashikuar për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, konkludon se kërkuesi i ka ezauruar të gjitha mjetet ligjore për t'iu drejtuar kësaj Gjykate.

*B. Lidhur me pretendimin e Ministrisë së Drejtësisë për ekzistencën ose jo të titullit ekzekutiv*

25. Nga materialet e paraqitura, si dhe deklaratimet në seancën gjyqësore të përfaqësuesit të subjektit të interesuar, Ministrisë së Drejtësisë, i cili është në rolin e debitorit, rezultojnë që ky i fundit jo vetëm të mos ketë bërë asnjë veprim që të krijojë bindjen se ka vullnetin për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë, por ka refuzuar shprehimisht ekzekutimin e tij. Për këtë ai sjell si argument pretendimin se vendimi i formës së prerë i Gjykatës së Apelit nuk përbën titull ekzekutiv, pasi ai nuk është i plotë dhe nuk përcakton qartë detyrimin konkret të debitorit.

26. Gjykata vlerëson se ky pretendim është i pabazuar dhe duhet rrëzuar.

27. Neni 510 i KPC-së parashikon: *“Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv. Janë tituj ekzekutivë:*

*a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm.” ...*

Neni 511 i KPC-së parashikon: *“Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesën e kreditorit. Për këtë qëllim, lëshohet urdhri i ekzekutimit, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së kreditorit, i cili jepet ... për rastet e parashikuara në shkronjën “a” të nenit 510...”*

28. Pra, nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese çmon se që një vendim gjyqësor të konsiderohet titull ekzekutiv, ai duhet të ketë marrë formë të prerë, pra të mos ketë më mundësi ankimi ndaj tij ose shfuqizimi, si dhe të jetë lëshuar një urdher për ekzekutimin e tij. Në çështjen objekt shqyrtimi, vendimi i Gjykatës së Apelit, i cili ka lënë në fuqi vendimin e KSHC-së, ka marrë formë të prerë dhe për këtë arsye Gjykata e Apelit ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit. Në këtë rast, detyrimi rrjedh nga vendimi i KSHC-së, i cili konsiderohet si vendim i një organi *quasi* gjyqësor dhe si i tillë i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjitha organet e administratës publike vendore dhe qendrore (neni 8/3 i ligjit nr. 8549, 11.11.1999 *“Statusi i nëpunësit civil”*). Vendimi që jep KSHC ngjason me vendimin e dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë, nisur nga tiparet e tij dhe fuqinë detyruese që ligjvënësi i ka dhënë në rastet kur ai nuk ankimohet (*shih vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 24.1.2007*).

29. Gjithashtu, subjekti i interesuar pretendon se është në pamundësi të ekzekutojë vendimin e formës së prerë për shkak se ai si titull ekzekutiv është i paqartë dhe nuk saktëson masën e detyrimit, sa i takon pagesës ndaj kreditorit. Edhe këtë pretendim Gjykata e gjen të pabazuar. Detyrimi i debitorit kundrejt kërkuesit është i përcaktuar ose i përcaktueshëm. Sipas vendimit të KSHC-së, i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, pala e paditur, Ministria e Drejtësisë, detyrohet: a) *të rikthejë kërkuesin* në pozicionin e mëparshëm të punës; dhe b) *të paguajë kërkuesin* nga momenti i



ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në ekzekutimin e plotë të këtij vendimi.

30. Lidhur me pikën (a) të vendimit, Gjykata Kushtetuese vëren se kërkuesi ka hequr dorë gjatë seancës nga ky pretendim pasi ka mbushur moshën e daljes në pension dhe për pasojë vendimi i formës së prerë në këtë pjesë nuk mund të ekzekutohet më. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese vendosi se të gjitha pretendimet e Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me rikthimin në punë të kërkuesit nuk do të analizohen.

31. Sa i takon detyrimin të dytë të debitorit, *pagesës së kërkuesit*, Gjykata Kushtetuese vlerëson se edhe ky detyrim është i përcaktueshëm për shkak se:

Së pari, në dispozitivin e vendimit të KSHC-së përfshihet shprehja “nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare”. Gjykata çmon se e vetmja marrëdhënie financiare që ka pasur kërkuesi me subjektin e interesuar, Ministrinë e Drejtësisë, është ajo e pagës kundrejt shërbimit apo punës që ai ofronte në pozicionin e përgjegjësit në Sektorin e Kontrollit Gjyqësor. Pra, në këtë kontekst është e qartë se pagesa do të llogaritet mbi bazën e pagës mujore të kërkuesit nga momenti i largimit nga puna deri në momentin e kryerjes së pagesës nga debitorit.

Së dyti, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 306, datë 13.6.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, pika 14 parashikon se: “Në rastin kur ndaj nëpunësit është marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil dhe Komisioni vendos shfuqizimin apo ndryshimin e vendimit të eprorit të drejtpërdrejtë, nëpunësi merr pagën e plotë që nga çasti kur janë ndërprerë marrëdhëniet financiare.” Kjo dispozitë parashikon qartë dhe saktë se nëpunësi i larguar mbi bazën e një vendimi të paligjshëm, i cili si i tillë është ndryshuar nga KSHC-ja, përfiton masën e pagës së plotë që nga momenti i largimit. Vendimi i KSHC-së për kërkuesin mbështetet pikërisht në këtë vendim të Këshillit të Ministrave.

32. Pra, si përfundim, Gjykata konkludon se titulli ekzekutiv i lëshuar nga Gjykata e Apelit është i qartë dhe konkret dhe si i tillë nuk ekziston asnjë arsye për pengesë në ekzekutimin e tij nga ana e debitorit. Gjykata Kushtetuese e sheh me vend të theksojë se Zyra e Përmbartimit Tiranë nuk ka gjetur vështirësi në marrjen e masave për zbatimin e vendimit, pra përlllogaritjen e detyrimit që rrjedh prej tij. Për këtë flasin veprimet e ndërmarra aktualisht nga Zyra e Shërbimit Përmbartimor Tiranë për ekzekutimin e tij, megjithëse rezultati nuk ka qenë i suksesshëm, për shkak të refuzimit të vazhdueshëm nga ana e debitorit.

#### *C. Lidhur me karakterin “civil”ose jo të së drejtës objekt shqyrtimi*

33. Ministria e Drejtësisë ka parashtruar se pretendimet e kërkuesit janë jashtë fushës së veprimit të nenit 6/1 të KEDNJ-së pasi akti i emërimit të kërkuesit, për shkak të detyrës dhe funksioneve të tij si një funksionar publik, është një akt tipik i së drejtës administrative. Për pasojë, sipas subjektit të interesuar, procedurat e lidhura me ekzekutimin e vendimit të KSHC-së janë krejtësisht administrative dhe nuk mund të cilësohen si procedura që përcaktojnë një të drejtë me karakter civil, sipas nenit 6/1 të KEDNJ-së.

34. Gjykata Kushtetuese çmon se edhe ky pretendim i subjektit të interesuar është i pabazuar dhe duhet rrëzuar.

35. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, e ka shtrirë detyrimin për respektimin e së drejtës për një proces të rregullt sa në proceset gjyqësore aq edhe administrative. Ajo ka theksuar se “në çdo rast Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut vendos standardet e domosdoshme dhe garancitë që çdo shtet kontraktues, duhet të sigurojë për të realizuar një proces të rregullt ligjor dhe jo rrethin e personave që duhet të përfitojnë prej saj. Ajo çmon se procesi i rregullt ligjor zbatohet për të gjitha konfliktet që janë vendimtare për pozicionin juridik të një personi, qoftë ai edhe funksionar publik. Pra, Gjykata Kushtetuese e shikon pozicionin e funksionarit publik në këndvështrimin e garancive që i siguron Kushtetuta, jurisprudenca e saj e deritanishme dhe fryma e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata Kushtetuese ka parasyrsh edhe dallimin që ekziston ndërmjet nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenit 42/1

*të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë. Ndërsa në Konventë parashikohet e drejta e individit për një gjykim të drejtë penal apo civil, në nenin 42/1 të Kushtetutës dhe në jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ” (shih vendimin nr. 76, datë 25.4.2002 të Gjykatës Kushtetuese).*

36. Nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se çështja objekt shqyrtimi hyn në sferën e kompetencës së saj.

#### IV

##### *D. Në lidhje me themelin e kërkesës*

37. Ekzekutimi, brenda një afati të arsyeshëm, i një vendimi të formës së prerë të gjykatës, duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjyqimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (shih vendimet nr. 12, datë 15.4.2011, nr. 35, datë 27.10.2010, nr. 23, datë 17.5.2010, nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese).

38. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj të konsoliduar, tashmë ka theksuar se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (shih vendimet nr. 12, datë 15.4.2011, nr. 35, datë 27.10.2010, nr. 23, datë 17.5.2010, nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese).

39. Gjykata Kushtetuese ka rikonfirmuar në shumë vendime të saj qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.12, datë 15.4.2011; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009; nr.1, datë 19.1.2009).

40. Po ashtu, Gjykata Kushtetuese, duke u bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në mënyrë të vazhdueshme, ka rikonfirmuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes, dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e aplikantit dhe autoriteteve përkatëse, si dhe interesin e aplikantit. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shpresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme. Për sa i përket sjelljes së aplikantit/kërkuesit, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se përdorimi nga ana e aplikantit i të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tij. Për sa u përket sjelljes së autoriteteve, është theksuar se edhe në ato sisteme ligjore, të cilat zbatojnë parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve, përsëri gjykatat kanë detyrimin për të siguruar progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme (shih vendimet nr. 12, datë 15.4.2011, nr. 35, datë 27.10.2010, nr. 23, datë 17.5.2010, nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese).



41. Gjykata Kushtetuese vëren se çështja objekt gjykimi, ndryshe nga sa pretendon subjekti i interesuar, nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike apo ligjore, çka mund të justifikonte vonesat apo sjelljen mosvepruese të organeve të ngarkuara nga ligji, Ministria e Drejtësisë dhe Zyra e Përmbarrimit.

42. Për sa i përket sjelljes (veprimeve) të kërkuarit, siç u theksua dhe më lart, Gjykata Kushtetuese konstaton se kërkuari ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e së drejtës së cenuar.

43. Për sa u përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëjloj. Në rastin në shqyrtim, përmbarruesi gjyqësor, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, ka qenë i pajisur me të gjitha mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Nga dokumentet bashkëngjitur dosjes rezulton se veprimet e kryera nga përmbarruesi gjyqësor kanë qenë të pasuksesshme për shkak të mosushtrimit të të gjitha kompetencave nga ana e tij. Përmbarruesi është mjaftuar vetëm me një shkresë lajmërimi nr.543/Sh, prot. nr. 7799, datë 16.6.2008, për ekzekutim vullnetar, pa filluar asnjë procedurë ekzekutimi të detyrueshëm, të parashikuar nga Kodi i Procedurës Civile, ndaj Ministrisë së Drejtësisë.

44. Ndërsa Ministria e Drejtësisë ka shprehur haptazi vullnetin e saj për të mos vënë në ekzekutim vendimin e formës së prerë, me argumentin se vendimi gjyqësor nr. 159, datë 3.5.2007, i Gjykatës së Apelit Tiranë, nuk ka e ngarkuar atë me ndonjë detyrim konkret e si i tillë, ky vendim nuk mund të jetë i ekzekutueshëm.

45. Nga sa më sipër, nisur nga afatet kohore dhe deklaratimet në seancën gjyqësore të zhvilluar për këtë qëllim, Gjykata konstaton se debitori ka pasur kohë të mjaftueshme në dispozicion për të ekzekutuar detyrimin ndaj debitorit. Ai jo vetëm që nuk e ka bërë këtë, por nuk ka shfaqur deri tani asnjë vullnet dhe predispozitë, si dhe vazhdon të shprehë hapur se nuk do të kryejë asnjë veprim në plotësim të detyrimeve të tij ndaj kreditorit pavarësisht kohës që kalon, sepse ai nuk e konsideron vendimin për lëshimin e urdhrit ekzekutiv si titull ekzekutiv ose, në rastin më të mirë, e konsideron atë të paqartë.

46. Si përfundim, Gjykata konstaton se ndodhet para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit, brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit gjyqësor të formës së prerë vetëm në pjesën që parashikon pagimin e pagës nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në ekzekutimin e vendimit, pasi para kreditorit nuk ekziston asnjë shpresë ose mjet ligjor që ta detyrojë debitorin të shlyejë detyrimin ndaj tij.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

#### VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit, brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit gjyqësor të formës së prerë vetëm në pjesën që parashikon pagimin e pagës nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në ekzekutimin e vendimit.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Petrit Ploçi, Admir Thanza, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha

**VENDIM**  
**Nr.8, datë 28.2.2012**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	anëtar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Petrit Ploçi	anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	anëtar	i	“	“
Admir Thanza	anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare	e	“	“
Vitore Tusha	anëtare	e	“	“

me sekretare Enina Mullaj, në datat 13.10.2011 dhe 2.11.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 40/16 akti, që i përket:

**KËRKUES:** Arjanit Hasani, përfaqësuar nga avokatët Julian Kola dhe Leonard Lame, me prokurë

**SUBJEKTI I INTERESUAR:** Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si të papajtueshme me Kushtetutën, i vendimeve: nr. 153, datë 15.4.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr. 445, datë 18.12.2008 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 130 datë 12.2.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 17, 43, 131/f, 134/1 shkronja “g” dhe 134/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatoren e çështjes, Vitore Tusha; përfaqësuesin e kërkuetit që kërkoi pranimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Kërkueti është deklaruar fajtor nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 153, datë 15.4.2008, për kryerjen e veprës penale “të shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese” dhe në bazë të neneve 114/a, pikat 4, 5, dhe 34/5 të Kodit Penal (KP) është dënuar me 12 vjet burgim dhe 1.000.000 lekë gjobë.

2. Mbi ankimin e ushtruar nga familjarët e kërkuetit, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 445, datë 18.12.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 153, datë 15.4.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

3. Kolegji Penal, në Dhomë Këshillimi, me vendimin nr. 130, datë 12.2.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit.



## II

4. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në këto aspekte:

4.1 Është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe ajo e Apelit gjatë gjykimit të çështjes nuk kanë pranuar kërkesa për marrjen dhe për vlerësimin e provave që paraqisnin rëndësi për çështjen.

4.1.1 Gjykatat kanë rrëzuar kërkesën e kërkuesit për të dërguar letërporosi pranë autoriteteve italiane, për të konfirmuar zyrtarisht nëse është bërë kallëzim nga e dëmtuara V.Z (ish-bashkëshortja) dhe nëse kërkuesi është dënuar për të njëjtën vepër penale në shtetin italian.

4.1.2 Gjykata e Apelit nuk ka riparuar shkeljet e mësipërme dhe, gjithashtu, nuk ka dhënë përgjigje mbi kërkesën e paraqitur nga kërkuesi në gjykim për zbardhjen (deshifrimin) e procesverbalit të seancave gjyqësore të zhvilluara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Ndonëse kjo kërkesë u paraqit bashkërisht nga Prokuroria dhe kërkuesi, Gjykata u shpreh vetëm për pranimin e heqjes dorë nga kërkesa të Prokurorisë.

4.2 Gjykatat kanë cenuar nenin 32, pika 2 të Kushtetutës, pasi kërkuesi është deklaruar fajtor mbi bazën e një prove të marrë në mënyrë të paligjshme. Dëshmia e shtetases V.Z është marrë në kundërshtim me nenin 158, pika 1, shkronja “ç” të Kodit të Procedurës Penale (KPP), pasi ajo nuk është vënë në dijeni të së drejtës për të mos dëshmuar.

4.3 Është cenuar standardi kushtetues i arsyetimit të vendimeve gjyqësore në kuptim të nenit 142/1 të Kushtetutës. Vendimet e fajësisë nuk pasqyrojnë tërësinë e fakteve dhe rrethanave siç janë administruar në gjykim dhe as mënyrën mbi bazën e së cilës janë analizuar dhe vlerësuar provat që kundërshtojnë njëra-tjetrën.

4.4 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke mos pranuar rekursin për shkak të mosnënshkrimit nga mbrojtësi, ka mohuar të drejtën e aksesit të kërkuesit në gjykatë.

## III

*A. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*

5. Kërkuesi ka pretenduar se standardi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit janë cenuar si pasojë e mospranimit nga gjykatat të kërkesave për të dërguar letërporosi pranë autoriteteve italiane dhe për zbardhjen (deshifrimin) e procesverbalit të seancave gjyqësore të zhvilluara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

6. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka trajtuar në mënyrë të vazhdueshme rëndësinë e respektimit të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, veçanërisht në procesin penal. Këto standarde kushtetuese kërkojnë që argumentet e mbrojtjes të paraqiten dhe të dëgjohen ashtu si ato të prokurorit dhe presupozojnë që secilës palë duhet t'i ofrohen mundësi të arsyeshme, për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e vënë në disavantazh me palën tjetër. Synim kryesor i këtyre parimeve është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, çka ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e të vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 18.9.2008, nr. 23, datë 23.7.2009*).

7. Gjykata, bazuar në materialet e administruara në dosje, konstaton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në vendimin nr. 153, datë 15.4.2008 ka arsyetuar se “në gjendjen që janë aktet nuk çmohej e domosdoshme dërgimi i letërporosisë, për faktin se deklarimet e të dëmtuarës V.Z përputheshin në tërësinë e tyre me deklarimet e të pandehurit, përveç faktit të shfrytëzimit të prostitucionit”. Nga ana tjetër kërkuesi, gjatë gjykimit kushtetues, nuk arriti të ngrinte në nivel kushtetues pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit.



8. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si rezultat i refuzimit nga gjykatat e zakonshme të marrjes së provave dhe vlerësimit jo të duhur të tyre, është i pabazuar.

*B. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale*

9. Kërkuesi pretendon, gjithashtu, se refuzimi nga gjykatat e zakonshme të kërkesës për dërgimin e letërporosisë pranë autoriteteve italiane për të konfirmuar zyrtarisht kallëzimin nga e dëmtuara V.Z. dhe dënimin për të njëjtën vepër penale në shtetin italian ka cenuar parimin *ne bis in idem*.

10. Gjykata është shprehur se parimi i mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale (*ne bis in idem*) është njohur si një prej të drejtave të njeriut të mbrojtura nga Kushtetuta dhe një nga instrumentet kryesore juridike të brendshme e ndërkombëtare, sipas të cilit askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht për një vepër penale për të cilën është shpallur më parë i pafajshëm ose është dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar. Ideja e parimit *ne bis in idem* nuk qëndron te zbatimi i dy a më shumë herë i së njëjtës normë penale, por te mosgjykimi e mosdënimi përsëri i subjektit për të njëjtën vepër penale, për të cilën ai është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e caktuar me ligj. Kriteri “e njëjta vepër” i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepër penale dhe kualifikim ligjor të tyre, të cilat formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilin personi është dënuar apo liruar. Nëse gjenden elemente të njëjta, parimi *ne bis in idem* ndalon çdo dënim tjetër ose procedim të mëtejshëm (*shih vendimet nr. 5, datë 8.3.2005, nr. 10, datë 2.4.2009; nr. 33, datë 22.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata konstaton se nga dokumentet e ndodhura në dosjen gjyqësore dhe nga argumentet e parashtruara nga kërkuesi gjatë gjykimit kushtetues, nuk rezulton të ketë nisur ndonjë procedim penal në ngarkim të kërkuetit apo ai të jetë dënuar me vendim të formës së prerë, për veprën për të cilën ai është dënuar në shtetin shqiptar.

12. Në këto kushte, Gjykata arrin në konkluzionin se pretendimet e kërkuetit për cenimin e parimit *ne bis in idem* janë haptazi të pabazuara.

*C. Në lidhje me pretendimin për mosdeklarimin fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*

13. Kërkuesi ka pretenduar se dëshmia e shtetases V.Z. është marrë në kundërshtim me nenin 158, pika 1, shkronja “ç” të KPP-së, pasi ajo nuk është vënë në dijeni të së drejtës për të mos dëshmuar. Për rrjedhojë, deklarimi i tij fajtor është bazuar mbi një provë të marrë në mënyrë të paligjshme.

14. Gjykata, në jurisprudencën e saj është shprehur se në kuptim të nenit 131, shkronja “f” të Kushtetutës, individit mund t’i drejtohet kësaj Gjykate për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike. Rregulli i vendosur nga dispozita e mësipërme kushtetuese e detyron kërkuetin, që për zgjidhjen e çështjes së tij, t’u drejtohet të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme përpara se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Kërkuesi legjitimohet vetëm kur shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor. Shterimi nënkupton që kërkuesi duhet t’i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 17, datë 16.5.2011*).

15. Gjykata konstaton se nga përmbajtja e dokumenteve të administruara në dosjen gjyqësore, pretendimi i mësipërm nuk është ngritur nga kërkuesi në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, duke mosrespektuar kështu standardin kushtetues të shterimit të mjeteve juridike përpara paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, sanksionuar nga neni 131, shkronja “f” e Kushtetutës.



16. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se kërkuesi, lidhur me këtë pretendim, nuk legjitimohet të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues.

*Ç. Në lidhje me pretendimin për mosarsyetimin e vendimeve gjyqësore*

17. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se vendimet e dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Gjykata e Apelit Durrës, nuk kanë pasqyruar me saktësi dhe vërtetësi faktet dhe rrethanat e çështjes dhe kanë arritur në përfundime të gabuara, pa u bazuar në provat e administruara gjatë gjykimit të çështjes. Për rrjedhojë, këto gjykata kanë cenuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve, parashikuar nga neni 142/1 i Kushtetutës.

18. Gjykata rithekson se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42, 142/1 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta apelojnë këtë vendim, si dhe organeve të apelit ta shqyrtojnë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet: nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 25, datë 10.6.2011, nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykatat duhet të parashtojnë në mënyrë të përmbledhur rrethanat e faktit, provat mbi të cilat bazohet vendimi, mënyrën e vlerësimit të këtyre provave, pra të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet mbi të cilat mbështesin vendimet e tyre. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve, në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet: nr. 33, datë 8.12.2005, nr. 23, datë 4.11.2008, nr. 36, datë 26.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërrënie ose kontradiksion, të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese: nr. 7, datë 9.3.2009 dhe nr. 23, datë 23.7.2009*).

21. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese dhe në rrethanat e çështjes, Gjykata vlerëson se nuk rezulton që vendimet e kundërshtuara të jenë jologjike, të kenë kundërrënie, të mos kenë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojnë elementet e përmendura më sipër. Gjithashtu, argumentet e Gjykatës së Rrethit Elbasan dhe të Gjykatës së Apelit Durrës janë të mjaftueshme për të mbështetur vendimet e tyre.

22. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se këto vendime gjyqësore nuk cenojnë standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit dhe se pretendimi i kërkuesit, në këtë aspekt, është i pabazuar.

*D. Në lidhje me pretendimin se i është mohuar aksesit në Gjykatën e Lartë si rezultat i mospranimit të rekursit të panëshkruar nga mbrojtësi*

23. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se mospranimi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, i rekursit të panëshkruar nga mbrojtësi, i ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë. Sipas tij, mungesa e nënshkrimit të mbrojtësit nuk mund të sjellë detyrimisht mohimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për të marrë përgjigje mbi shkaqet e ngritura në rekurs.

24. Gjykata ka vlerësuar se neni 435/2 i KPP-së, i cili parashikon se “*rekursi dhe memoriet që i drejtohen Gjykatës së Lartë duhen të nënshkruhen nga mbrojtësit e të pandehurve*”, ka për qëllim të garantojë mbrojtjen me avokat të të pandehurit, në rastin kur ai ushtron rekurs. Standardi i mbrojtjes me avokat në Gjykatën e Lartë nuk garantohet plotësisht nëse respektohet vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor. Rekursi është akti procedural në të cilin parashtrohen shkaqet për të cilat kundërshtohet një vendim sipas kërkesave të nenit 432 të KPP-së, që mundëson të drejtën e të

pandehurit për të filluar gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe, në këtë kuptim, ai është akti me të cilin garantohet e drejta për akses në këtë gjykatë. Kërkesa kushtetuese dhe procedurale për të garantuar mbrojtjen efektive dhe profesionale të të pandehurit në Gjykatën e Lartë, ka kuptim, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë të pandehurit për të ushtruar të drejtat që parashikon procedura penale. Qëllimin e ligjvënësit, për të garantuar mbrojtës në këtë proces, e shpreh edhe detyrimi që kjo normë i ngarkon kryetarit të kolegjit, për të caktuar një mbrojtës kryesisht për të pandehurin, i cili nuk ka mbrojtës të zgjedhur.

25. Megjithatë, Gjykata ka theksuar se veprimtaria seleksionuese e Dhomës së Këshillimit, është veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Në këtë kuptim, në vështrim të jurisprudencës së kësaj Gjykate, mospranimi i rekursit në Dhomën e Këshillimit kur nuk është bërë për shkak të mosnënshkrimit të tij nga mbrojtësi, por sepse nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga dispozitat procedurale përkatëse, si një nga kriteret për refuzimin/pranimin e rekurseve, nuk përbën cenim të aksesit në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin nr. 37, datë 19.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata konstaton se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi) në vendimin nr. 130, datë 12.2.2010, arsyeton se: “*rekursi i paraqitur nga i pandehuri Arjanit Hasani, nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së dhe nuk përmban nënshkrimin e mbrojtësit ashtu siç e parashikon neni 435/2 i KPP-së*”.

27. Gjykata vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në pjesën arsyetuese të vendimit ka konstatuar faktin e mosnënshkrimit të rekursit nga ana e mbrojtësit në referim të nenit 435/2 të KPP-së dhe, gjithashtu, ka bërë vlerësim mbi ekzistencën e shkaqeve të parashtruara në rekurs, duke arritur në përfundimin se shkaqet e pretenduara nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Mbështetur në arsyetimin e mësipërm dhe, bazuar në nenin 433 të KPP-së, që parashikon se rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij.

28. Gjykata vlerëson se Kolegji Penal nuk i ka cenuar, në thelb, kërkuesit të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë, për arsye se ky Kolegji ka verifikuar nëse ishin shkaqet e kërkuara nga neni 432 i KPP-së.

29. Në vështrim të standardeve të mësipërme dhe rrethanave të çështjes, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesit Arjanit Hasani nuk i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në vështrim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me unanimitet,

#### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Sokol Berberi, Petrit Piloçi, Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza



**VENDIM**  
**Nr.9, datë 29.2.2012**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	anëtar	i	“	“
Petrit Plloçi	anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	anëtar	i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar	i	“	“
Admir Thanza	anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare	e	“	“
Vitore Tusha	anëtare	e	“	“

me sekretare Elta Milori, në datën 22.12.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 54/29 akti, që i përket:

**KËRKUES:** Basri Bejtja, përfaqësuar nga avokati Ferdinand Doja, me prokurë

**SUBJEKTI I INTERESUAR:** Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 626, datë 10.10.2007 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 31/ç, 42/2, 43, 131/f, 134/g të Kushtetutës; neni 27 e vijues i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”; neni 6/3, shkronja “c” i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Vitore Tusha; përfaqësuesin e kërkuarit që kërkoi pranimin e kërkesës dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 250, datë 23.12.1999 e ka deklaruar kërkuarin fajtor për veprat penale të “vrasjes me dashje e mbetur në tentativë” dhe të “armëmbajtjes pa leje” dhe e ka dënuar me 10 vjet burgim.

2. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 134, datë 24.6.2002, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë kësaj gjykate, por me një trup tjetër gjykes.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 364, datë 29.12.2004, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuarit për veprat penale të “vrasjes me paramendim të mbetur në tentativë” dhe të “mbajtjes pa leje të armëve luftarake”. Në mbështetje të neneve 78/1 e 23 dhe 278/2 të Kodit Penal (KP) kërkuari është dënuar, respektivisht, me 12 vjet dhe 2 vjet burgim. Në zbatim të nenit 55/3 të KP-së, kërkuari është dënuar, përfundimisht, me 12 vjet burgim.

4. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 280, datë 25.10.2005, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke e deklaruar kërkuarin fajtor për veprën penale të “kanosjes”, parashikuar nga neni 84 i KP-së dhe pushimin e gjykimit të

çështjes bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 8895, datë 16.05.2002 “Për dhënien e amnistisë”. Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi deklarinimin fajtor dhe masën e dënimit për veprën penale të armëmbajtjes pa leje të armëve luftarake, 2 vjet burgim.

5. Proceset gjyqësore në gjykatat e mësipërme janë zhvilluar në mungesë të kërkuesit, i cili ka qenë i përfaqësuar nga mbrojtës të zgjedhur nga familjarët me pëlqimin e tij.

6. Gjykata e Lartë, mbi ankimin e prokurorit, me vendimin nr. 626, datë 10.10.2007, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 280, datë 25.10.2005 dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 364, datë 29.12.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që e dënonte të pandehurin me 12 vjet burgim.

7. Në datën 7.3.2011, kërkuesi është arrestuar në shtetin italian me kërkesë të shtetit shqiptar.

## II

8. *Kërkuesi* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 13.6.2011, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në këto aspekte:

- Është cenuar e drejta e mbrojtjes, si rezultat i mosrespektimit të kërkesave të Kodit të Procedurës Penale (KPP) në lidhje me njoftimin e rekursit të pandehurit në mungesë ose mbrojtësit të tij. Kërkuesit i është mohuar e drejta që argumentet e mbrojtjes të dëgjohen si ato të prokurorit, duke cenuar barazinë e armëve dhe gjykimin kontradiktor.

- Është cenuar parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, pasi procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë, për shqyrtimin e rekursit të paraqitur nga prokurori është zhvilluar në mungesë të të pandehurit, të mbrojtësit të tij dhe nuk i është caktuar një mbrojtës kryesisht.

## III

### A. Në lidhje me legjitimitimin e kërkuesit

9. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) thekson se çështja e legjitimitimit të kërkuesit lidhet drejtpërdrejt me inicimin e një procesi kushtetues. Individit, në kuptim të neneve 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “g” dhe pika 2 të Kushtetutës, mund të vërë në lëvizje këtë Gjykatë për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*.

10. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, Gjykata vlerëson se në vështrim të nenit 30, pika 2 e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, kërkesat e individit për shkeljen e të drejtave kushtetuese paraqiten jo më vonë se 2 vjet nga konstatimi i shkeljes.

11. Gjykata konstaton se gjykimi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në mungesë të kërkuesit, të mbrojtësit të caktuar nga familjarët (me pëlqimin e tij) dhe pa ju caktuar mbrojtës kryesisht. Vendimi i dhënë nga Kolegji Penal në përfundim të procesit gjyqësor nuk i është komunikuar as kërkuesit personalisht dhe as mbrojtësit të caktuar nga familjarët.

12. Gjykata vlerëson se marrja dijeni e kërkuesit për përmbajtjen e vendimit nr.626, datë 10.10.2007 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk provohet të jetë bërë me ndonjë mënyrë tjetër, përveç njoftimit të këtij vendimi në datën 7.3.2011, kur kërkuesi është arrestuar në shtetin italian për llogari të autoriteteve shqiptare. Për rrjedhojë, kërkuesi legjitimohet *ratione temporis* për vënien në lëvizje të gjykimin kushtetues.

13. Gjykata konstaton, gjithashtu, se shqyrtimi i pretendimi të kërkuesit se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 626, datë 10.10.2007, i ka mohuar atij të drejtën e mbrojtjes, si një nga standardet e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, është *prima facie* në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione materiae*.



*B. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës së mbrojtjes në Gjykatën e Lartë*

14. Kërkuesi pretendon se procesi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të mbrojtjes, barazisë së armëve, gjykimit kontradiktor dhe mosrëndimit të pozitës së të pandehurit. Sipas kërkuesit, shqyrtimi i rekursit të paraqitur nga prokurori dhe zhvillimi i procesit në Gjykatën e Lartë në mungesë të tij, të mbrojtësit të tij dhe mosaktimi i një mbrojtësi kryesisht i kanë rënduar pozitën dhe i kanë mohuar të drejtën që pretendimet e tij të dëgjohen njëjloj si ato të prokurorit.

15. Gjykata ka vlerësuar se e drejta e një personi të akuzuar, për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij, është thelbësore për një proces të drejtë. Kjo e drejtë përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte. Edhe pse nuk është absolute, e drejta e çdokujt, të akuzuar për një vepër penale, për t'u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor, është një nga kriteret kryesore të gjykimit të drejtë. Një person i akuzuar penalisht nuk e humb këtë të drejtë thjesht për faktin se ai nuk ndodhet vetë personalisht në gjyq (shih vendimin nr. 45, datë 10.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

16. Që e drejta e mbrojtjes të jetë reale dhe efektive, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë, jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësit në gjykim, por dhe t'i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale duke respektuar barazinë e armëve (shih vendimin nr. 10, datë 2.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese).

17. Sipas praktikës së kësaj Gjykate, si dhe të GJEDNJ-së, është detyrë e autoriteteve shtetërore përkatëse që të njoftojnë në mënyrë rigoroze, konform kërkesave procedurale, të pandehurin ndaj të cilit ka filluar një proces penal, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet në përfundimin se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim. Vërtetimi i këtyre fakteve, sipas Gjykatës, është detyrë e organeve kompetente. Me këtë detyrim të organeve përkatëse shtetërore, për të njoftuar në mënyrë rigoroze të pandehurin dhe për të provuar se ai i fshihet drejtësisë, është e lidhur e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, si dhe e drejta e gjykatës për të vendosur për gjykimin e tij në mungesë, kur janë respektuar në mënyrë rigoroze dispozitat për njoftimin (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 45, datë 10.10.2011).

18. Gjykata rithekson se veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe, lidhur ngushtë me këto, realizimi i mbrojtjes së të pandehurit, garantuar shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së, përbëjnë në vetvete elementet më thelbësore, të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Këto elemente thelbësore të procesit të rregullt ligjor duhet të respektohen në të gjitha shkallët e gjykimit, duke përfshirë dhe atë në Gjykatë të Lartë. Në dallim nga procedurat strikte të gjykimit që zhvillohen në gjykatat e zakonshme, gjykimi në Gjykatën e Lartë, ka si veçori paraqitjen vetëm të argumenteve ligjore. Kompleksiteti i procedurave të gjykimit në Gjykatën e Lartë konfirmohet dhe nga dispozitat që sanksionojnë se palët duhet të përfaqësohen në këtë gjykim nga avokati. Prandaj, shqyrtimi në Gjykatën e Lartë kryesisht të çështjeve të ligjit, jo vetëm që justifikon plotësisht përfaqësimin me avokat në seancën dëgjimore, por për më tepër, bëhet i domosdoshëm për garantimin në favor të të pandehurit të një mbrojtjeje efektive dhe profesionale (shih vendimet: nr. 28, datë 2.10.2009, nr. 37, datë 24.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

19. Gjykata ka theksuar se interesat e drejtësisë kërkojnë detyrimisht realizimin e mbrojtjes, qoftë edhe me avokat të caktuar kryesisht, të të pandehurit që gjykohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, në të cilin, ndër të tjera, kërkohet një rëndim i pozitës së tij në krahasim me vendimin e dhënë për këtë çështje nga gjykata e apelit (shih vendimin nr. 37, datë 24.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

20. Në rastin në shqyrtim, nga analiza e materialeve shkresore që gjenden në dosjen gjyqësore në emër të kërkuesit, konkretisht procesverbali i seancës të parë gjyqësore në Gjykatën e Lartë, i datës 20.6.2007, rezulton se seanca gjyqësore nuk është zhvilluar dhe është shtyrë në një datë të mëvonshme, pasi Kolegji Penal ka konstatuar se komunikimi i rekursit nuk ishte bërë në rregull, ishte i pafirmosur dhe kishte një shënim ku thuhej “*ky person ndodhet jashtë shtetit*”.

21. Gjykata e Lartë, me shkresën nr. 925 akti, datë 20.6.2007 ka vënë në dijeni Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për shtyrjen e seancës dhe i ka kërkuar komunikimin e rekursit. Sipas dëftesë-komunikimit të datës 3.8.2007, rezulton se është dërguar një kopje e rekursit të prokurorit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, por është bërë shënimi se “personi nuk gjendet, është jashtë shtetit”.

22. Sipas procesverbalit të seancës së datës 10.10.2007, rezulton se gjykimi në Gjykatën e Lartë ka vazhduar vetëm në prani të prokurorit dhe në mungesë të kërkuesit dhe të mbrojtësit të caktuar nga familjarët (me pëlqimin e tij). Në përfundim të seancës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 280, datë 25.10.2005 që e dënonte të pandehurin me 2 vjet burgim dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 364, datë 29.12.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që parashikonte një masë më të rëndë dënimi për kërkuesin, 12 vjet burgim.

23. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, në kushtet kur rekursi ishte paraqitur nga prokurori, për Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë dilte e domosdoshme marrja e masave në mënyrë që të mos lejonte zhvillimin e gjykimit në mungesë pa i dhënë mundësi palës së akuzuar (kërkuesit) të realizonte mbrojtjen ligjore përmes mbrojtësit të caktuar nga familjarët me pëlqimin e tij apo mbrojtësit të caktuar kryesisht nga gjykata.

24. Si përfundim, Gjykata vlerëson se, në tërësinë e tij, procesi gjyqësor i zhvilluar në Gjykatën e Lartë, në aspektin kushtetues, ka qenë i parregullt, pasi kërkuesit i është cenuar e drejta e mbrojtjes me avokat në këtë gjykatë.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë,

#### VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimit nr. 626, datë 10.10.2007 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Admir Thanza, Fatmir Hoxha

Anëtarë kundër: Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 12.3.2012  
Doli nga shtypi më 14.3.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2012

Çmimi 44 lekë